

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail: gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7577 E martë 3 Korrik 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Dje në "Deutsche Welle"

Qytetarët e Gjermanisë vetëm tundi kokën me mosbesim përballë shfaqjeve teatrale qoftë në Berlin, qoftë në Mynih. "Po kthejuni ore më në fund asaj ..."
Vijon në faqen 20

Nga FELIX STEINER

Politikë në stilin e vetëshkatërrimit



Opinion i Ditës

Nga ANDI BUSHATI

Përprjekja e pak zërave cilësorë dhe autoritarë, po fatkeqësisht të pakët në numër, në mbrojtje të godinës së Teatrit Kombëtar, është një nga betejetat ...
Vijon në faqen 21

Teatri si monumenti i fundit i qytetit dhe lirive tona



Kryeministri i prerë: Do ndërtohet i riu

Rama: Teatri e ka humbur bastin, artistët të mos merren me mure

"Më trishton Robert Ndrenika. I takon vendimmarrësve të votuar që të vendosin"

FATMIRA NIKOLLI

Tingujt e La Boheme tërhiqin kalimtarët dje në orën 20:30 në skenën e re të artit Turbina, pranë Liqenit. Oborri që plot me artistë të Operës e Baletit (që edhe performuan) me në krye drejtoreshën dhe ata të Metropolit ...
Në faqen 17

KRYEPROKURORJA DEKLARON 5.4 MILIONE LEKE, KREDI PER SHTEPI NE SHKODER

"VETINGU", ZBARDHET PASURIA E ARTA MARKUT

Në 15 vitet e fundit familja pati 25 milionë lekë të ardhura. BIRN: "Flamur i kuq", bashkëshorti bashkëpronar në 2015 në një shtëpi të padeklaruar më parë



(Në foto) Kryeprokurorja e perkohshme, Arta Marku

ELBASAN

Vodhi dyqanin, 50-vjeçari plagos 3 policë me gërshtë. E ëma: Eshhtë i sëmurë

Në faqen 10

KRYETARI I PD

Basha thumbon të huajt: Ata që thonë puthuni me Ramën janë "au" fare

Në faqen 2

FLET KRYETARJA

Sindikata e arsimit: Mësuesit, 6 vjet pa marrë shpërblimet e fundit të vitit

Në faqen 12

LISTA E RE

Hipoteka: 420 pronarët që kanë gati tapinë në qarkun e Shkodrës

Në faqen 14-15

TURIZMI



"Prestige Resort" mirëpret drejtuesit e mediave të huaja: Kompleks fantastik

Në faqen 13

Durrës/ Policia arreston menaxherin Agron Kryeziu, në kërkim pronari italian

Tritol në fabrikë, punëtorët: Kolegu ynë, pa faj

Policia i akuzon për trafik. Punonjësit: Dyshojmë për motiv konkurrence

Nga KLODIANA HAXHIAJ

DURRËS- Agron Kryeziu, i cili u arrestua nga policia për kallëpjet e tritolit nuk është menaxher i fabrikës së plastikës. Ai është punëtor i thjeshtë si ne. Nuk besojmë se ai ka lidhje me ngjarjen. Dyshojmë se ngjarja mund



të ketë marrë shkas për motive konkurrence". Kështu u shprehën dje punëtorët e fabrikës së plastikës "Group Compozites" në Porto Romano të Durrësit, ku mesditën e së shtunës u sekuestruan katër kallëpe tritolit të lidhura me kapsolla ...
Në faqen 11

NEGOCIATAT DEBATI

Valentina Madani

Kreu i PD-së, Lulzim Basha para të rinjve akuzoi dje fort kryeministrin Edi Rama si pengesa kryesore e mos hapjes së negociatave me BE-në. Sipas tij nuk hapen negociatat me një kryeministër të lidhur me drogën. Basha në një takim me një grup të rinjsh kujtoi dje 2 korrikun e 1990-ës, datën në të cilën 28 vite më parë, qytetarët e Tiranës hynë në ambasadën gjermane duke paralajmëruar fundit e regjimit diktatorial. Gjatë fjalës së tij Basha falënderoi të gjithë ata të rinj që në atë kohë u futën në ambasadë dhe çanë digën që sipas tij sollli edhe shembjen e murit të diktaturës. Lideri i PD nuk kurseu as kritikën për ambasadorët e huaj, ndërsa theksoi se këta të fundit nuk po mbajnë qëndrim për negociatat. Kreu i opozitës bëri të ditur se nuk do të bashkëpunojë për këtë çështje me qeverinë. Basha ishte i prerë kur tha se nuk pranon leksione për bashkëpunim dhe puthje, pasi PD nuk bashkëpunon me qeverinë e krimit dhe drogës. E vetmja rrugë që i hap dyert e Europës Shqipërisë sipas tij është largimi i qeverisë Rama. "Ata që bëjnë leksione, jo bashkëpunimi, jo puthuni janë aut fare, ju ka mbaruar koha. Partia Demokratike nuk bashkëpunon me qeverinë e krimit dhe drogës. PD e ka bërë punën e saj për hapjen e negociatave, duke parë të vërtetat në sy, duke ju thënë europianëve kështu është siç thoni ju, por pikërisht se është kështu na duhet ndihma juaj dhe hapja e negociatave do të ishte një ndihmë shtesë për t'i mbajtur përgjegjës. Por nuk mjaftoi as kërkesa jonë dhe as aspirata e gjithë shqiptarëve. As një vendi nuk i janë hapur negociatat në këto kushte ku është Shqipëria sot. Detyra jonë e parë është të çlirojmë politikën nga krimi dhe kjo nuk vjen duke i dhënë falje Edi Ramës, por duke i rregulluar Edi Ramës dhe qeverisë së tij të lidhur me krimin derën, duke e larguar këtë qeveri. Vetëm kjo na çon tek hapja e negociatave", deklaroi z.Basha. Kreu i opozitës akuzoi më tej se Edi Rama qëndron pas planit për ndërtime dhe kullave tek Teatri Kombëtar, duke pastruar paratë e drogës dhe duke fituar 200 mln euro. Basha tha se nuk hapen negociatat me një kryeministër të lidhur me drogën. "Vetëm çlirimi i politikës nga krimi hap negociatat. Nga oligarkët, pesë oligarkë kontrollojnë sot Shqipërinë. Ky që bën stadiumin me kullë

Kreu i PD e cilëson investim donkishotesk dhe replikon me Fleckenstein për negociatat

Basha thumbon Vlahutin: Ata që thonë 'puthuni', janë aut fare

"PD nuk bashkëpunon me qeverinë e krimit"



Kreu i PD-së, Lulzim Basha

REPLIKA

Elida Petoshati u shpreh: "Ishte një vendim marrje kolektive ku edhe Danimarka dha mbështetjen, bashkë me vendet e tjera unanimisht që të nisnin negociatat e anëtarësimit në 2019". Por Kodheli u përgjigj: "Ka qenë një nga vendet skeptike lidhur me proceset integruese dhe hapjen e negociatave".

REPLIKA

"Më vjen keq që edhe sot ka pasur një investim donkishotesk edhe nga ndonjë i huaj që është bërë vegël e Edi Ramës, që flet për çdo gjë, vetëm për problemin jo. Problemi këtu nuk është bashkëpunimi opozitës-qeveri. Problemi është lidhja e qeverisë me krimin. Ata që thonë 'bashkëpunoni, kërcëni bashkë dhe e puthuni' janë aut fare, ju ka mbaruar koha. Ne nuk bashkëpunojmë me qeverinë e krimit", - tha Basha.

Kandidatja për ambasadore: Danimarka mbështet integrimin, Kodheli: Skeptike për Shqipërinë

Tre emrat e përzgjedhur nga ministri i Jashtëm Ditmir Bushati si ambasadorë në Malin e Zi, Danimarkë dhe Bullgari si dhe Ambasador jo rezident në Moldavi zhvilluan dje seancën dëgjimore në Komisionin e Jashtëm ku nuk kanë qenë të pranishëm deputetët e PD-së. Elida Petoshati, kandidatja për ambasadore në Danimarkë garantoi se Danimarka mbështet procesin integruese, gjë që është kundërshtar nga kryetarja e komisionit, deputetja socialiste Mimi Kodheli. Ajo tha



se Danimarka ka qenë skeptike për proceset në Shqipëri. Elida Petoshati u shpreh: "Ishte një vendim marrje kolektive ku edhe Danimarka dha mbështetjen, pëligjimin, bashkë me vendet e tjera unanimisht që të nisnin

negociatat e anëtarësimit në qershor të vitit të ardhshëm". Por Kodheli u përgjigj: "Ka qenë një nga vendet skeptike lidhur me proceset integruese dhe hapjen e negociatave". Sipas kandidatës për ambasadore në Danimarkë, së shpejti do të ketë një linjë ajrore mes vendit tonë dhe Danimarkës. E vetmja përfaqësuese e opozitës në Komision, ish-ministria e Integritimit Klajda Gjoshja, e shfrytëzoi këtë moment për të thënë se as qershori i vitit që vjen nuk është data e hapjes së negociatave.

hedhin këtë hap, do të përballesh me vendosmërinë totale të opozitës dhe shqiptarëve. Në orën 19:00 t'i bashkëngjiteni artistëve të vërtetë. Në atë projekt grabitës monstroz, ku pastron paratë e drogës, 50% do t'i marrë Edi Rama. 200 mln euro fitim. Prandaj vijmë

Alibeaj nxjerr 'audio-përgjimin' e Ramës: Ky u bën nënën shqiptarëve. Manja: Vrasësit s'mund të bëjnë moral

Mbledhja e djeshme e Komisionit parlamentar të Ligjeve, u shoqërua me debate të ashpra mes opozitës dhe opozitës ku u diskutua pr/ligji për Teatrin Kombëtar. Opozita akuzoi deputetët e mazhorancës se janë kullak në duart e Edi Ramës për të vjedhur 200 mln euro. Deputeti i PD-së, Enkelejd Alibeaj, tregoi audio përgjimin sipas tij të Edi Ramës që i përgjigjet me sharje një qytetari në telefon. Alibeaj më pas është përfshirë në debat me Ulsi Manjën, i cili i tha Alibeajt se është një aktor i denjë për Teatrin e ri.

DEBATI TE 'LIGJET', ALIBEAJ-DEPUTETETË MAZHORANCËS: PO FRIKË NGA BURGU KENI?

ENKELEJD ALIBEAJ: A merrni ndonjë dorë eurosh apo jo, u lënë ndonjë koncesion apo jo, a merrni ndonjë para drogë a jo? Nxjerr përgjimin e bisedës telefonike. Ky është ai njeriu që thotë ju bëfsha nënën dhe ju bëfsha robti, turp e faqe e zezë, mbironi ndërën tuaj personi dhe mos u bëni pjesë e atij bastardi!

ULSI MANJA: Interpretim i denjë për teatrin e ri, interpretim politik i shkëlqyer, aktor më të mirë nuk ka për të pas teatri.

Ndërhynj Vokshi

ULSI MANJA: Albania ia kemi marrë dorën me ashtu regjistrimet, turpin secili ta mbajë për veten

ALBANA VOKSHI: Po ta mbajë ai i pari, ai ta mbajë!

ENKELEJD ALIBEAJ: Jeni kullaku në dorën e Ramës. Po mirë frikë burgun e keni apo jo? Është fundi i institucioneve publike sigurisht edhe karrierës suaj, por mos i jepni fund inteligjencës suaj. Pse duhet të shënohet në CV tënde se ka hapurit, bashkëpunim me Edi Ramën?

ULSI MANJA: Përmbylle!

ENKELEJD ALIBEAJ: Me sjelljen tuaj pjesë e një organizate të strukturuar kriminale për të vjedhur. E vetmja gjë që mbetet në këtë rast të themi është se cila është pjesa juaj në këtë vjedhje? Mos u përdorni në këtë mënyrë. Është faturre e madhe politike, ligjore. Sepse me këtë çfarë po bëni ju, jua thashë dhe njëherë modestisht jeni duke konsumuar vepra të qarta penale. Nuk ju shpëton fakti që jeni deputetë, për më tepër që është dhe faturre e madhe morale. Hiçin nga rendi i ditës. Mos u bëni pjesë e kësaj. Ndëroni për aq sa mund të ketë ngelur beitim që keni bërë në kushtetutë. Që do mbron kushtetutën, Rregulloren e Kuvendit dhe interesin e publikut. Masha të verba jeni duke u bërë. Gjurmët e këti krimi po u shkruan sot.

ULSI MANJA: Zoti Alibeaj ju tërheq vëmendjen për shkëlqjen e kodit të etikës.

ENKELEJD ALIBEAJ: Nuk ma tërheq dot ti vëmendjen. Kodi moral i hajduqi këtu.

ULSI MANJA: Ju jeni kod moral i vrasjes. Jeni bashkëfajtorë në vrasje dhe akuzoni për hajdutë. Ju tërheq vëmendjen për shkëlqje të Kodit Etikës së sjelljes. Ju ngjitur komision hetimor për të hetuar grushtin e shtetit ku u vranë 4 qytetarë. Nuk mund të tregoni moral. Vrasësit tregojnë moralin. Të kanë thënë të vish të besh zhurmuesin. Kujdes kur tregon gishtin nga unë. Vrasësit s'mund të ngrenë gishtin.

KLEVIS BALLIU: Je i pacipi. Je ekspert i dhunës ndaj grave.

ULSI MANJA: Detësi 5 minuta pushim sa të qetësohet zoti Balliu.

KLEVIS BALLIU: Mbatja se e keni bërë rrugë.



Kreu i PD-së, Lulzim Basha, dje në një takim me një grup të rinjsh të FRPD-së



Eurodeputeti vjen në Tiranë për të diskutuar hapat pas vendimit të Këshillit të BE

Fleckenstein: S'ka kushte shtesë, Merkel bëri të pamundurën të bindë Macron

Vlahutin: Vit i vështirë, PS t'i shtrijë dorën opozitës

Darina Tanushi

Eurodeputeti, Knut Fleckenstein bëri të qartë dje, në Tiranë se për Shqipërinë nuk ka kushte shtesë sa i përket çeljes së negociatave në qershor 2019. Gjatë një tryeze të rrumbullakët me temë: "Çfarë e pret Shqipërinë pas konkluzioneve të Këshillit të BE", zyrtari evropian, i bëri thirrje politikës të avancojë me reformën në drejtësi dhe reformën zgjedhore. Ndërsa ambasadorja e BE-së në Tiranë, Vlahutin në prani edhe të deputetëve të PS-së dhe opozitës tha se integrimi evropian nuk është për axhenda të fshehura. Ajo bëri thirrje për dialog dhe jo retorikë mes palëve në Kuvend. Në tryezën e organizuar nga Fondacioni Friedrich Ebert, Knut Fleckenstein u shpreh: "Ka kushte, por nuk janë kushte të reja. Askush nuk duhet ndaluar së punuari deri në çeljen e negociatave. Duhet vazhduar puna me vettingun, një ligj të mirë me reformën elektorale. Qeveria duhet të përshpejtojë këtë proces. Këto nuk janë kushte të reja". "25 nga 28 shtetet do të kishin thënë: ok, vazhdoni. 6 nga 8 grupet kanë thënë që të vazhdojnë me negociatat. Merkel ka bërë të pamundurën që ta bindë presidentin Macron. Do kishte qenë më e suksesshme po të kishte qenë përfundimi me i shkurtër. Urime dhe duke qenë serioz do kisha dashur që negociatat të kishin filluar një vit më parë por është një rezultat i mirë. Dhe ato që kanë qenë skeptike nuk e kanë bërë për Shqipërinë, por për të reformuar brenda njëri-tjetrit. Por disa shtete kanë thënë që reformat brenda vetes duhet ti bëjmë me njeri-tjetrin", u shpreh Fleckenstein.

"Për Shqipërinë e rëndësishme është të bëjë detyrat e shtëpisë. Europa po vlerëson reformat dhe përjekjet e bëra për këto reforma. Në Gjermani ne kemi një rregull që nuk funksionon gjatë gjithë kohës. Ky rregull është që ne, politika në Gjermani luftojmë brenda vetes sonë brenda kufirit, por që jemi unik jashtë vendit dhe në raport me vendet e tjera kërkojmë të jemi sa më të



Eurodeputeti, Knut Fleckenstein dhe ministri për Europën dhe Punët e Jashtme, Ditmir Bushati


KEJDI MEHMETAJ

Deputetja e LSI-së, Kejdi Mehmetaj kritikoi mënyrën se si ishte organizuar dje, tryeza me reporterin për Shqipërinë Knut Fleckenstein. "Ishte tërësisht e njëanshme dhe opozita nuk ishte e ftuar si e barabartë në një diskutim që duhet të përfshijë të gjithë aktorët e shoqërisë shqiptare", - tha ajo dje.

Ministri i Jashtëm: Do të nisim me kapitujt për drejtësinë, sigurinë

Bushati: Për reformën zgjedhore duhet opozita, rrota e dytë e biçikletës

Ministri për Europën dhe Punët e Jashtme, Ditmir Bushati deklaroi dje, në tryezën, për hapat e radhës të Shqipërisë për integrimin se "duke u nisur nga precedentit që BE-ja ka vendosur me Malin e Zi dhe Serbinë, e dinim që do të ishte një vendim me afat kohor". "Mendoj që një vit është një kohë e mjaftueshme për punën përgatitore si për ne dhe si për fqinj tonë", - tha Bushati. Konkluzionet e Këshillit të BE, theksoi ministri Bushati, "thjesht pasqyrojnë evolucionin e përbushjes së kriterëve në këtë proces. 12 kriteret janë vendosur në momentin kur Shqipëria ka aplikuar për t'u bërë anëtare e BE. SPAK-u dhe vettingu nuk kanë qenë ndon-



jëherë kusht për Shqipërinë. Shqipëria ka zgjedhur vetë për të pasur prani ndërkomitëtare në procesin e vettingut". "Tashmë konkluzionet e Këshillit të BE pasqyrojnë atë që ka thënë edhe Komisioni Evropian. Sot askush s'e vë në pikëpyetje që procesi i vettingut ka

nisur dhe tashmë duhet që të vijojë ky proces. Tashmë duhet konsolidimi i reformave në fushën e zbatimit të ligjit", - tha ministri Bushati. Ai tha se në muajin korrik nis puna analitike për kapitujt që duhen plotësuar. "Fillimisht për kapitujt 23,24, që janë kapitujt që kanë lidhje me lirinë, drejtësinë, sigurinë dhe të drejtat e njeriut", u shpreh Bushati. Ministri Bushati foli dhe për ligjin elektorale, ku një nga konkluzionet e Këshillit flet për mbajtjen në vëmendje dhe adresim të rekomandimeve të OSBE-ODIHR. "Por jemi vetëm njëra rrotë e biçikletës, sepse biçikleta ka dy rrota në këtë drejtim. Duhet dhe rrota tjetër, që është opozita dhe nuk duhet humbur kohë", - tha z. Bushati.

GJERMANIA

Anke Holstein, e ngarkuara me punë e Republikës Federale të Gjermanisë, deklaroi dje, se "Gjermania pret nga Shqipëria që të zbatojë konkluzionet e Këshillit". "Ne jemi të gatshëm që të ndihmojmë Shqipërinë në përbushjen e kërkesave. Gjërërat që po shikon parlamenti gjerman dhe parlamentet e vendeve të tjera janë shumë të qarta në lidhje me luftën kundër kimit të organizuar, korrupsionit dhe përbushjes së procesit të vettingut", - tha ajo.



Ballu: Mund të kishim marrë edhe 'Jo' nga BE, ftesa për opozitën, e hapur

Përtej pritshmërive tona, Shqipëria ka marrë një "Po", një datë, dhe ka filluar punën parapërgatitore, e cila nuk do të zgjasë më shumë se 12 muaj", - deklaroi dje, kreu i grupit parlamentar të PS-së, Taulant Balla. I pranishëm në tryezën e rrumbullakët të organizuar në Tiranë, me temë "Çfarë pritet nga Shqipëria pas konkluzioneve të Këshillit të BE për çështjet e përgjithshme: Pritshmëritë dhe detyrat", Balla tha: "Përgjigjia mund të ishte 'Jo', pa datë dhe mund të kishte filluar puna parapërgatitore që mund të zgjaste edhe 2 vjet". "Ka pasur një debat përse nuk kishte një datë konkret brenda vitit 2019 për tryezën protokollare mes qeverisë shqiptare dhe kolegjit të komisionerëve. E vetmja datë politike në axhendën europiane të vitit të ardhshme janë vetëm zgjedhjet në maj", - tha Balla. Duke u ndalur të hapat që duhet të ndërmarrë Kuvendi i Shqipërisë, Balla theksoi se "nuk duhet të ketë tentativë për bojkot dhe duhet një frymë bashkëpunimi mes palëve". "Në emër të maxhorancës ftesa është gjithmonë e hapur. Ne kemi disa orientime me adresimin tërësor të rekomandimeve të OSBE/ODIHR-it. Ajo që është e rëndësishme për rrugën europiane të Shqipërisë është adresimi në kohë i raportit të OSBE/ODIHR-it", -tha Balla.

unifikuar në qëndrim. Nuk e di nëse ka vend tjetër me këtë lloj specifikë, pasi çdo vend ka mënyrën e tij të funksionuarit. E rëndësishme është të bashkëpunohet dhe jo të ketë përjashtim, të gjithë duhet të jemi bashkë në këtë rrugëtim", - tha eurodeputeti Knut Fleckenstein. "Duhet një opozitë që nuk bojkoton, por që mbështet reformat", u shpreh Fleckenstein. Edhe ambasadorja e BE-së, në Tiranë, Romana Vlahutin bëri thirrje për konsensus politik. "Ky proces kërkon që të ketë bashkim, jo retorikë. In-

tegrimi evropian nuk është për axhenda të fshehura. E kemi parë në disa vende por dhe këtu, disa grupe interesi e kanë kuptuar se çfarë është BE, por ka dhe disa grupe që nuk nxitojnë, sepse nuk e duan BE. Shumica dhe pakica duhet të bashkëpunojnë. Shumica të shtrijë dorën e dialogut, sepse pa këtë, procesi është pothuajse i pamundur", u shpreh Vlahutin. Ajo tha se vendin e pret një vit i vështirë duke pasur parasysh dhe zgjedhjet lokale të vitit 2019. "Janë 3 elemente që shtrihen për-

para nesh, kur unë them që s'po humbasim asnjë sekondë të vende, procesi analitik nis që këtë verë. Është punë shumë e rëndësishme, pavarësisht se ku do ishte linja e nisjes zyrtare. Me reformën në drejtësi keni bërë përparime, por kërkohet ende kohë, për më thellë e gjerësisht. Pa reformën në gjyqësor nuk do ishim duke e bërë këtë bisedë sot. Do të keni një sfidë të madhe dhe kjo është politika. Ky proces kërkon që të ketë bashkim, duhet një objekt i mirë i përfillt", -shtroi Vlahutin.

BASHKËQEVERISJA PLATFORMA

Kryeministri kërkon bashkëpunimin e qytetarëve: Presion mbi administratën

Darina Tanushi

Kryeministri Edi Rama kërkoj dje, sërisht bashkëpunimin e qytetarëve për të shkundur administratën, në mënyrë që ajo të jetë në shërbim të qytetarëve. Gjatë bilancit të përjavshëm me koordinatorët e platformës së bashkëqeverisjes me qytetarët www.shqiperiaqeduam.al, Rama dëgjoj disa nga rastet e zgjidhura, Rama tha se platforma e bashkëqeverisjes me qytetarët ia ka dalë për të zgjidhur problemet, disa prej të cilave i publikoi në një takim me koordinatorët e bashkëqeverisjes. Kreu i qeverisë tha se për çdo problem të zgjidhur ka edhe të ndëshkuar ndaj bëri edhe apel që qytetarët t'i bashkohen platformës. "Çdo rast i zgjidhur është edhe një rast i ndëshkuar: ku për çdo vonesë, zvarritje, pengesë të krijuar në mënyrë që bie ndesh me ligjin për qytetarin të ketë përgjegjësi konkrete individësh që të ndëshkohen me të gjitha masat e parashikuara nga kodi i punës apo kodi i shërbimit civil", u shpreh Rama. Sa i përket asaj pjese të administratës që Rama e quan parazite, kryeministri kërkoj bashkëpunimin e qytetarëve që të denoncojnë çdo rast padrejtësie. "Vendosja e administratës dhe e zyrave të shërbimeve në një presion nga lart dhe poshtë, sjell si rezultat edhe identifikimin e personave problematike, identifikimin e punonjësve indiferentë, parazitë apo edhe grabitqarë që po nuk të futën dorën në xhep nuk të japin zgjidhje për atë që të takon me ligj dhe zakon", u shpreh kryeministri. Duke folur për rastin e një 17 vjeçari nga Hasi, i cili ishte dërguar në platformën për të siguruar punë, për të mbajtur familjen pas vdekjes së babait, Rama foli edhe për punësimet. "Ajo që vlen të theksohet në dëshminë e Samuelit është se menjëherë, kërkesës së tij për punë, duke pasur parasysh natyrshisht jo theksit mundësitë fizike, por edhe kualifikimin e munguar në këtë fazë të jetës së tij, ne iu përgjigjëm. Shfrytëzimet momentin për të bërë një thirrje për të gjithë ata që duan të punojnë dhe nuk e kanë kusht që o punë shteti, o s'ka, që t'i drejtohen edhe zyrës së bashkëqeverisjes, e cila ka një sërë eksperiencash pozitive ndërmjetësimi me zyrat e punës. Ashtu sikundër mund t'i drejtohen edhe drejtpërdrejtë zyrës së punës në zonën e tyre, pasi jemi në një fazë të re të ecurisë së zyrave të punës dhe kemi çdo muaj, qindra e qindra raste të zgjidhura", u shpreh Rama. Duke

Edi Rama: Për çdo problem të zgjidhur, ka edhe të ndëshkuar

"Drejtohuni në zyrat e bashkëqeverisjes për punë në privat"



Kryeministri Edi Rama

Rasti i Samuelit, në punë 17 vjeç, pas vdekjes së babait, kërkon strehim nga Rama

Rasti i parë, i cili është paraqitur sot në këtë takim, që gjeti zgjidhje përmes platformës së bashkëqeverisjes ishte rasti i Samuelit nga Hasi, i cili kishte kërkuar punësim. Shërbimi Kombëtar i Punësimit në zonën përkatëse në bashkëpunim me Zyrën e Bashkëqeverisjes siguroi punësim për 17-vjeçarin brenda 10 ditëve, në një prej kompanive që po ndërton rrugë pranë zonës ku ai banon. Duke falënderuar për dhënien e kësaj mundësie punësimi, i riu kërkoj po ashtu edhe strehim për familjen e tij. "Baba ka që në muajin shkurt që më ka vdekur. Më ka rënë një barrë shumë e rëndë mbi shpinë. Mendoj që edhe zoti Kryeministër duhet të shikojë rastin tim. Kam nevojë për mbështetje e tij. Nuk është problemi që vetëm unë të punësohem. Kam edhe dy motrat më të mëdha, edhe mami që është e aftë për punë. Por edhe strehimin. Strehimi është një gjë që e kërkoj që kur, sepse shtëpia që banoj është e xhaxhallarëve. Kjo barrë që më ka rënë tash prej 4-5 muajsh është shumë e rëndë, sepse nuk ia dija as babait tim që kur e kisha gjallë, mendoja vetëm të dilja, të shëtisja me shokët, sepse nuk e dija se çfarë më priste. Këtë gjë e kuptova pas vdekjes së tij. Kërkoj nga zoti kryeministër, të paktën, vetëm strehimin ta kem të sigurt, sepse dita-ditës shtëpia edhe po shembet, edhe xhaxhallarët kërkojnë që të dal nga ajo shtëpi, se nuk është e imja", u shpreh Samuel Shatri.

folur për platformën, Rama tha se "nuk është zëvendësim i institucioneve, por është një inovacion teknologjik që ka transformuar zyrat e pafundme të pritjes së qytetarëve, të cilat në të shumtën e herës kanë qenë jo funksionale për dekada me radhë, në një instrument në dispozicion

të qytetarëve përmes iPhone-t, përmes lidhjes së drejtpërdrejtë me internetin në zyrën përkatëse të njësive administrative, në zyrën e postës, apo dhe në zyrat e bashkëqeverisjes që ne i kemi hapur enkas. Gjë që ia bën të mundur çdokujt, pavarësisht moshës, pavarësisht vend-

DEKLARATA

"Xhagajdurët i kemi të përbashkët, duhet t'i luftojmë së bashku. Ndërkohë të jeni të bindur që për sa i përket ecurisë së përditshme në rastet e ditës dhe jo në ato të prapambeturat ka një përmirësim që ka filluar të ndihet tek administrata. Ka filluar të krijohet, ende jo sa duam dhe sa duhet, fryma e përgjegjësisë dhe përgjegjshmërisë ndaj qytetarëve dhe kjo është pozitive", -tha dje, Rama.

Përplasje në Komisionin e Ekonomisë

Spahia: Të diskutohet ligji për teatrin, Erjonush/ Braçe: S'merr vesh nga kjo punë

Mbledhja e Komisionit të Ekonomisë u shoqërua dje, me debate të ashpra, mes deputetëve të opozitës dhe të mazhorancës. Deputetja e PD-së, Jorida Tabaku kërkoj që në rendin e ditës të vihet edhe çështja e Teatrit, ndërkohë kryetari i komisionit, Erjon Braçe i është përgjigjur se çështja e Teatrit po diskutohej në dy komisionet e tjera. Më pas debati ka vazhduar mes Braçes edhe Bardh Spahisë. Pas përplases së ashpër Braçe ndërpreu mbledhjen e komisionit.

DEBATI I PLOTË:

TABAKU: Sot ka një kollaps me sistemin e taksave. Sot prona publike po falet, po grabitet, po i jepet një privati. Pasi qeveria rriti taksat me 5 mld euro nuk gjen dot para për Teatrin. Oligarkët janë duke marrë çdo tender. Negociatat nuk u hapën. Sot me pr/ligjin e Teatrit është afëra më e madhe. Votat tona nuk do t'i ketë. Me këtë ligj shkelet Kushtetuta e vendit. Shkelet ligji i koncesioneve.

ERION BRAÇE: Më vjen keq, po dua t'iu them që ligji që kemi përpara është tatimi mbi të ardhurat të ndryshuar dhe mendoj që ky ligj që ul tatimin 5% për subjektet që do të merren me agroturizëm, është me interes.


SPAHIA: Duhet të diskutohet ligji i Teatrit.

BRAÇE: S'merr vesh nga kjo punë ti. Shko në Komisionin e Shëndetësisë, bëj ndonjë punë atje.

SPAHIU: O Erjonush. Ndërpritet mbledhja e Komisionit.

dodhjes, pavarësisht mundësive, që të ketë akses në vetëm 3 minuta dhe pastaj t'i hapë rrugë zgjidhjes së një problemi brenda 10 ditësh". "Vendosja e administratës dhe e zyrave të shërbimeve, në radhë të parë, në një presion nga lart dhe nga poshtë sjell si rezultat edhe iden-

tifikimin e personave problematikë, identifikimin e punonjësve indiferentë, parazitë apo dhe grabitqarë, që po nuk fute dorën në xhep, nuk të japin zgjidhje për atë që të takon me ligj dhe pas identifikimit të merren masat përkatëse", theksoi kryeministri.



Vasili: Ndjekje penale Ramës, mashtrori për audiopërgjimin e Xhafajt

Kryetari i Grupit Parlamentar të LSI-së, Petrit Vasili kërkoj dje, ndjekje penale për kryeministrin Rama pasi gënjeu për audiopërgjimin. "Rama të ndiqet penalisht se gënjeu për audiopërgjimin, ç'shiklet ka... kryeprokuroria që s'vepron? Sot u bë publik në media se audiopërgjimi i vëllait të ministrit të Brendshëm nuk është pranuar të verifikohet e ekspertohej nga Italia dhe po kërkohet në Angli që t'i bëhet një derman", tha Vasili. Sipas tij, "Kryeministri mashtrori në mënyrë ordinere në 16 maj kur deklaroi publikisht dhe live se e kishte bërë vetë si verifikimin dhe kishte dalë i pastër". Sipas Vasilit kryeministri mashtron publikisht duke folur se bën gjoka hetime e verifikime të paligjshme me qëllim mashtrimin e opinionit, deformimin e hetimit dhe imponimin e rezultateve të tij. "A hap dot hetim Arta Marku para një fajti penal të tillë të madh sa një mal? Ha ha ha po si mund ta bëjë kryeprokuroria këtë? Mbetet që kryeministri po të dojë mund të hetojë kryeprokuroren e kundërta nuk mund të ndodhë kuuuurrë. Sa gjynah kryeprokuroria e shkretë.... Shqiptaret janë shumë të qartë që kanë një kryeministër halabak dhe një hiç kryeprokurore", u shpreh Vasili.



Pala shqiptare dhe pala greke duket se janë pranë zgjidhjes së problemeve mes dy vendeve. Gazeta greke "Protothema" ka mësuar detaje rreth marrëveshjes së Greqisë me Shqipërinë. Sipas saj, bëhet fjalë për një marrëveshje paketë që synon të zgjidhë çështjet e hapura. Marrëveshja pritet të bëhet publike në korrik, raporton "Protothema", ku do të firmoset nga një takim i përbashkët mes kryeministrave Edi Rama dhe Alexi Tsipras. Paketa e zgjidhjes së problemeve përbashkët heqjen e ligjit të luftës, heqjen e tarifave konsullore të dokumenteve qeveritare greke, hyrjen në fuqi të njohjes së patentave shqiptare, mbrojtjen e të drejtave të pakicës kombëtare greke, ndarjen e zonave ekskluzive detare, heqjen e termave irredentiste nga teksteve shkollore shqiptare dhe varrezat për ushtarët grekë. Shqipëria dhe Greqia do të firmosin, gjithashtu, një pakt të ri të miqësisë dhe bashkëpunimit. E përditshmja "Protothema" i mëshon faktit për Epirin e Veriut. "Japin Epirin e Veriut për Çamërinë që nuk ekziston", është titulli i këtij shkrimi. Sipas saj, pala greke ka pranuar që të heqë termin "Epiri i Veriut", megjithatë kjo nuk është e konfirmuar zyrtarisht. Nga ana tjetër, edhe Shqipëria nuk do të përdorë më termin Çamëria, shkruan gazeta greke. Në të dyja rastet, thuhet në artikull, nuk do të ketë pretendime formale territoriale. Edhe për çështjen e pronave do të ketë një pakt, por nuk do të ketë bëjë me kërkesat çame për pretendime territoriale. "Shumë nga këto pronat të bllokuara nga ligji i luftës, janë në Janinë, Selanik dhe në disa zona të rajonit të Thesalisë. Sipas tyre është rreth 15 milionë euro", shkruan "Protothema". Gazeta greke sjell, gjithashtu, në vëmendje se këto pika janë dakordësuar gjatë takimeve të përbashkëta mes ministrave të Jashtëm Ditmir Bushati dhe Nikos Kotzias, në nëntor 2017 në Kretë, në janar 2018 në Korçë, në mars 2018 në Tiranë, në maj 2018 në Sounion dhe

"Protothema" publikon pikat e marrëveshjes Shqipëri - Greqi: 'Dhamë Epirin e Veriut'

Pakti detar, mediat greke: Çamëria 'nuk ekziston më'

"Nga çfarë hoqi dorë pala greke si këmbim"



Ministrat e Jashtëm Ditmir Bushati dhe Nikos Kotzias

EPIRI I VERIUT
E përditshmja "Protothema" i mëshon faktit për Epirin e Veriut. "Japin Epirin e Veriut për Çamërinë që nuk ekziston", është titulli i këtij shkrimi. Sipas saj, pala greke ka pranuar që të heqë termin "Epiri i Veriut", megjithatë kjo nuk është e konfirmuar zyrtarisht.



Deputeti gjerman: Negociatat për Shqipërinë, jo para fundit të 2019

Thorsten Frei, raportuesi i grupit parlamentar CDU/CSU në intervistë për "Deutsche Welle" (shqip) deklaroi se vendimi i Brukselit për Shqipërinë dhe Maqedoninë nuk mund të merret as si "po" e as si "jo". I pyetur se kur mund të fillojnë negociatat e anëtarësimit, deputeti gjerman thotë se kjo do të varet, por jo përpara fundit të vitit 2019. Megjithatë ai shprehet se "ne si grup parlamentar i partive CDU e CSU, do ta kishim mirëpritur qysh tani një vendim për çelje negociatash me kushte". "Për Shqipërinë do të kishim qenë dakord për çeljen e negociatave nëse do të ishin përfunduar dy kushte: përfundimi i vetingut për 57 gjyqtarët dhe prokurorët më të lartë dhe përmbyllja e reformës zgjedhore", shprehet Frei.

Grekët: Çamëria nuk ekziston më

Idrizi: Duam takim urgjent me Bushatin, gati protestat masive

Gazeta greke "Protothema" zbuloi dje disa detaje nga marrëveshja mes Shqipërisë dhe Greqisë që pritet të firmoset së shpejti. Sipas gazetës pala greke ka pranuar që të heqë termin "Epiri i Veriut", megjithatë kjo nuk është e konfirmuar zyrtarisht, ndërsa nga ana tjetër, Shqipëria nuk do të përdorë më termin Çamëria. Pas lajmit ka reaguar kryetari i PDIU, Shpëtim Idrizi, i cili shprehet se Çamëria nuk shitet, nuk barazohet me Vorio-Epirin. Ai shprehet se do të kërkojë një takim me Bushatin, ndërsa në të kundërt do të ketë protestat masive. Shoqata "Çamëria dhe PDIU, do kërkojë në mënyrë të përsëritur dhe për herë të fundit takim urgjent me Z. Bushati, për të bërë transparencë dhe për t'i thënë dhe ministrit tonë të Jashtëm, që deri më sot ka folur boll me heshtjen e tij. Në rast të kundërt, e nëse dikush



PARALAJMËRIMI
"Në rast të kundërt, e nëse dikush mendon që ta tradtojë Çamërinë, ne do ftojme të gjithë shqiptarët në protesta masive, në bojkot të produkteve greke, duke radikalizuar fort qëndrimin tonë e të gjithë shqiptarëve patriotë, që i bashkon dinjiteti kombëtar!", -tha z. Idrizi.

tetë kombëtar nuk negociohet, por zgjidhet, ajo që i përket Shqipërisë është e shqiptarëve, na e kanë lënë amanet të parët, duhet t'ia lënë amanet të pa cenuar fëmijëve", theksoi z. Idrizi. Ai paralajmëroi se: "Shoqata 'Çamëria' dhe PDIU, do kërkojë në mënyrë të përsëritur dhe për herë të fundit takim urgjent me Z. Bushati, për të bërë transparencë dhe për t'i thënë dhe ministrit tonë të Jashtëm, që deri më sot ka folur boll me heshtjen e tij. Në rast të kundërt, e nëse dikush mendon që ta tradtojë Çamërinë, ne do ftojme të gjithë Shqiptarët në protesta masive, në bojkot të produkteve greke, duke radikalizuar fort qëndrimin tonë e të gjithë shqiptarëve patriotë, që i bashkon dinjiteti kombëtar!"

takimi më i fundit në ishullin Rodhos të premtën e kaluar. Shqipëria dhe Greqia kanë patur disa raunde bisedimesh për shumë nga çështjet kryesore që i ndajnë

dy vendet. Dorën e fundit të dakordësisë për çështjet e diskutuara pritet t'ia japin kryeministrat Rama dhe Tsipras, të cilët me gjasë fillimisht do të takohen në

Bruksel. Më pas, marrëveshja pritet të marrë firmat e Ramës dhe Tsipras në mesin e korrikut. Parashikohet që marrëveshja të nënshkruhet në ishullin e

Korfuzit. Grupi negociator shqiptar ka kërkuar që marrëveshja të marrë miratimin e parlamentit grek e më pas të firmoset nga dy kryeministrat.

ZYRA PËRMBARIMORE PRIVATE ENIRJETA ZISI

Permbarese gjyqesore private Enirjeta Zisi zhvillon ankandën për shitje e pasurisë se palauajtshme "Apartamenti" me sipërfaqe 92.1m2, ZK.3866, Nr.Pasurie.300/143+1-7 Vol.83,Fq.186,Indeksi i Hartes K-34-100, te ndodhur ne Tirane, Yzberisht prane ruges "Joklin Persi", kati 1,shk.1 ap.7 Tirane,per shperjten e detyrimin ne favor te kreditort Zveit Llanaj,

Çmimi i ri me të cilin shpallet ankandi është ne shumen 3.010.392 (tre mijlon e dhjete mijlo e treqind e nentëdhjete e dy) lekë.

Ankandi zhvillohet ne date 04.07.2018, ora 16.00 ne zyrën e Permbarese gjyqesore private Enirjeta Zisi,Bulevardi "Gjergj Fishta", Pallati "Gora"Kulla.2,Kati i 2, Tirane Nr.Tel. 0694799000, email:enirjeta.zisi@gmail.com

Permbarese gjyqesore Genti Bushati nxjerr per shitje ne ankand pasurine :

a) Tokë are e regjistruar ne regjistrin hipotekore me nr pasurie 582/1, volumi 10, Fage 248, ne zonen kadastrale nr 1100, me sipërfaqe totale 3230 m2, e ndodhur ne adresen Barbullush Shkoder b) Tokë are e regjistruar ne regjistrin hipotekore me nr pasurie 523/21, volumi 9, Fage 3, ne zonen kadastrale nr 1100, me sipërfaqe totale 2360 m2, e ndodhur ne adresen Barbullush Shkoder 2. Çmimi me të cilin do të fillojë shitja në Ankand për pasurinë e sipërshkruar, është në vleren Për pasurinë "Tokë Are" me sip 3230 m2, është në vleren 488.376 lekë

Për pasurinë "Tokë Are" me sip 2360 m2, është në vleren 356.832 lekë
Shitja e pasurisë fillon me date 04.07.2018 ora 16:16 ne Zyrën e Permbarese gjyqesore Genti Bushati me adrese Rruga Don Bosko, Feribeite Gjyqesore se rrethit Gjyqesore Shkoder. Personat e interesuar duhet te derdhen perpara fillimit te ankandit 10% te vleres si garanci ne Banken BKT dhe Shkoder me nr llogarie 41064051,

Shitje me Ankand te Pare nga Studio Permbarimore L.D.C

"Trulli e ndërtesë", me nr pasurie 31/12, ZK 3428, vol.5, fq.3 me sipërfaqe totale trulli 1.837 m2 dhe sipërfaqe ndërtesë 260.6 m2 me adrese Ishati Shtoi Ri, Shkoder. Regjistruar ne Z.V.R.P.P Shkoder ne emer te Zako Spaso Ajkoviq. Çmimi fillestar per shitje është 22.400.000 Leka.

Data e shpalljes 21.06.2018
Data e zhvillimit 13.07.2018 deri ne oren 16.00

Ankandi zhvillohet ne ambientet e Studios Permbarimore L.D.C me adrese Rruga "Myslim Shyri" Vila 8/1, kati 1 Tirane.

Komisioni i Veprimtarisë Prodhuese diskuton ligjin për avicionin civil

Çmimet e biletave ajrore - Kuvendi, AAC-së: Jepini fund abuzimit

Shalsi: Bëni analizë të detajuar mbi shkaqet

Ornela Manjani

Pavarësisht se shqetësi mi mbi çmimin e lartë të biletave të transportit ajror është ngritur shpesh, asnjëherë nuk është kryer një analizë e detajuar mbi shkaqet e kësaj situatë. Nisur nga kjo situatë, teksa nisi diskutimi mbi Kodin e ri Ajror, kreu i Komisionit parlamentar të Veprimtarisë Prodhuese, kërkoi nga Autoriteti i Aviacionit Civil të ndërmarrë këtë proces, për të parë më pas mundësitë e rishikimit të çmimeve. "Le që nuk ka ndodhur ndonjëherë, ka qenë një analizë e detajuar e përgjegjëseve, një krahasim adekuat i çmimeve të biletave. Na duhet t'i kërkojmë Autoritetit të Aviacionit Civil, autoriteteve përkatëse, një analizë krahasimore të biletave në rajon. E dyta, komponentët e çmimit të biletës dhe ku ndryshojnë tarifat e këtyre komponentëve për vendet e rajonit. Edhe fakti që ne do të kemi shumë shpejt dy aeroporte, kemi lançimin e aeroportit të Vlorës, kemi dhe vënien e aeroportit të Kukësit në përdorim, do jetë konkurrenca ajo që do të ulë çmimet, do të jetë heqja e monopolit, apo do të jetë ndërhyrja jonë tek disa komponentë të shtrenjtë brenda çmimit të biletës", tha Shalsi. Kërkesa erdhi pas prezantimit të dokumentit të ri nga kreu i Aviacionit Civil, Krislen Keri, i cili po shpjegonte një mekanizëm të ri për të mbrojtur kompanitë nga konkurrenca e pandershme nga ato kompani që aplikojnë çmime më të ulëta për udhëtarët. Por, kjo hasi në kundërshtimet e deputetëve, të cilët theksuan se problem janë çmimet e larta dhe jo ato të ulëta. "Në rast se konstatohet dhe ka indicie që në një linjë të caktuar, një kompani e caktuar është duke përdorur çmime përkohësisht të ulëta në mënyrë që të eliminojë konkurrencën tjetër, atëherë kjo është një praktikë që bie nën subjektin e pikës katër", -u shpreh Keri. Deputeti Dritan Bici reagoi duke thënë se: "Populli shqiptar po i nxihet jeta nga biletat e avionëve dhe unë për vetë jam për ta denoncuar këtë lloj veprimtarie që shqiptarët po persekutohen nga aeroportit civil i Rinanit. Jam për të mbajtur një qëndrim si komision, në qoftë se është bërë një koncesion i gabuar, ne ta denoncojmë dhe të fillojmë hetimet për atë koncesion të gabuar që mund të jetë bërë, por jo populli shqiptar të vazhdojë të vuarë". Në përfundim të



mblehdjes Shalsi e cilësoi Autoritetin e Aviacionit Civil si një nga institucionet më të politizuara, duke kërkuar marrjen fund të punësimeve partiake dhe duke e çliuruar nga punonjësit e paafët dhe jo specialistë të fushës.

HETIMI
Autoriteti i Konkurrencës ka

në një hetim paraprak të kryer pak ditë më parë ka dalë në konkluzionin se një e katërta e çmimit të një bilete në Shqipëri përbëhet nga taksat që vendos koncesionari i aeroportit të Tiranës. Në një vendim të datës 14 qershor, Komisioni i Konkurrencës ka

kërkuar nga autoritetet që të marrin masa nga abuzimet që janë duke bërë edhe kompanitë e fluturimit ajror me çmimin e biletave që tregtojnë në Shqipëri. Për këtë arsye Autoriteti i Konkurrencës i rekomandon Autoritetit të Aviacionit Civil që brenda

DEKLARATA

Ministri i Jashtëm hedh poshtë çdo dyshim për komunikimin me presidentin Meta për marrëveshjen e detit. Ai konfirmon se kreu i shtetit është dëgjues për çdo hap të bisedimeve mes Tiranës e Athinës. "Ne jemi në kontakte me presidentin për çdo raund bisedimesh. Në disa raste ai ka kërkuar informacion shtesë që i është dhënë", -tha Bushati.

Konkurrenca tregon se në monitorimin që i ka bërë një linje ajrore, Albanian Airlines, ka rezultuar se nga viti 2016 deri në 2017-ën çmimet e biletave janë rritur vetëm si arsye e rritjes së kërkesës për fluturime dhe jo e kostove të kompanisë. Abuzime të shumta janë gjetur edhe me shumë pasagjerë, të cilëve iu është anuluar fluturimi pa arsye dhe nuk kanë marrë kompensim, ndërsa vetë institucionet përgjegjëse nuk kanë marrë masa për të rregulluar këtë situatë. Në pikën e fundit të vendimit, Komisioni i Konkurrencës kërkon që edhe koncesionari i Rinanit duhet të marrë masat që të shfaqë në vende të dukshme brenda aeroportit informacionin mbi të drejtat e udhëtarëve dhe informimin e tyre për anulimet e fluturimeve. Vetëm në rastin e linjës Tiranë-Vjenë është evidentuar se çmimi mesatar i biletave është 190 euro, 7.7% më i lartë se mesatarja e rajonit.

90 ditëve të kryejë analizën e çmimeve që vendosin linjat ajrore dhe të parandalojë abuzimin me çmimet e larta se rezultat i pozitës dominuese që kanë shumë kompani. Në vendim zbulohet se Aviacioni Civil nuk ka një rregullorë ose metodologji për vendosjen e tarifave të bile-

Debat i për çmimin e bukës

Prodhuesit: Energjia për furrat me frigorifer, 8.5 lekë/kV

Mes debatesh të forta e Asambleja e Përgjithshme e Shoqatës së Prodhuesve të Bukës ka miratuar propozimin konkret që do i bëhet institucioneve mbi faturimin e energjisë elektrike. Ai vjen pas një kohe të gjatë bisedimesh mes institucioneve shtetërore dhe Shoqatës, ndërsa sipas kësaj të fundit është gjetur dakordësia për faturimin me 8.5 lekë/kV në ato furrat që kanë frigoriferë e ku tregtojnë prodhimet e tyre të pastërçisë. Ndonëse e votuan unanimisht propozimin, prodhuesit kërcënuan me ulje qepenash, madje edhe greva më të gjata se 24 orë, në rast se vendimi nuk miratohet nga Këshilli i Ministrave dhe Enti Rregullator i Energjisë. Po ashtu,



një pjesë e tyre e konsideruan të pavlefshëm debatin, duke kërkuar rritje të çmimit të bukës si një mënyrë për kompensimin e rritjes së kostove. Miratimi i këtij vendimi vjen pas debatit të zhvilluar mbi faturimin e energjisë së furrave të bukës, duke qenë se aktualisht këto subjekte

kanë një çmim preferencial prej 7.6 lekë/KV, por për shkak të frigoriferëve ku tregtojnë jo vetëm produktet e tyre, por edhe produkte të bulmetit po faturohen nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike me 14 lekë/kV çka ka rritur ndjeshëm kostot e prodhimit.

TVSH-së te biznesi i vogël: 10 korriku afati i fundit për të deklaruar e paguar

Data 10 korrik është afati final kur rreth 10 mijë biznes, që kanë hyrë në skemën e TVSH-së pas uljes së pragut nga 5 në 2 milionë lekë, do të duhet të deklarojnë dhe paguajnë për herë të parë tatimin mbi vlerën e shtuar. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka njoftuar se data 10 korrik 2018 është afati i deklarimit të librave të shitjes dhe blerjes për tatimpaguesit me qarkullim 2-5 milionë lekë, të përfshirë në skemën e TVSH-së që prej datës 1 prill 2018. Tatimpaguesit, duhet të mbajnë në konsideratë se të dhënat e blerjeve dhe shitjeve regjistrohen në librat e shitjes dhe blerjes në baza mujore. Dorëzimi i librave kryhet në mënyrë elektronike, nëpërmjet sistemit e-Filing, nëpërmjet llogarisë së deklarimit elektronik që ka vetë subjekti, në rubrikën "Librat e Shitjes dhe Blerjes". Brenda datës 10 korrik duhet të deklarohen librat e shitjes dhe blerjes për periudhat tatimore prill, maj dhe qershor. Në Librin e Shitjes, tatimpaguesi, duhet të regjistrojë në mënyrë kronologjike çdo faturë tatimore shitjeje të lëshuar prej jush, si dhe përmbledhjen e qarkullimit ditor të memorizuar të pajisjes fiskale në një shifër të vetme mujore. Po kështu, në Librin e Blerjes, tatimpaguesi regjistron çdo faturë blerjeje malli me dhe pa TVSH, sipas kolonave përkatëse. Totaliteti dhe dhënave, të regjistruara në librat e shitjes dhe blerjes, plotësohen në rubrikat përkatëse të Deklaratës mujore të TVSH-së, e cila është e thjeshtuar. Ajo dorëzohet po në mënyrë elektronike, nëpërmjet sistemit e-Filing. Deklaratat e muajve prill, maj dhe qershor duhet të dorëzohen brenda datës 16 korrik 2018.

Komisioni i Ekonomisë ka miratuar ndryshimet në paketën fiskale, duke ndryshuar shkallën e tatimit mbi Vlerën e Shtuar. Këshilli i Ministrave vendosi të lehtësojë barrën fiskale për një sërë kategorish si për bizneset, ashtu edhe për individët. Qeveria vendosi që fitimi kapital i realizuar si rezultat i kalimit të së drejtës së pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme, ndërtesë, truall dhe tokë bujqësore tatonet me normën 15 për qind. Shkëmbimi i truallit me sipërfaqe ndërtimi, në bazë të një kontrate shkëmbimi nuk përbën moment për llogaritje të ndon-

Komisioni i Ekonomisë miraton ndryshimet në paketën fiskale

Ulet tatimfitimi për bizneset me xhiro nën 14 milionë lekë në vit

jë fitimi kapital nga transferimi i pasurisë së paluajtshme. Shkalla e tatimit mbi fitimin për bizneset është ulur, pasi është ngritur baza e tatueshme. Kështu, tatimfitimi do të jetë 5% për tatimpaguesit me të ardhura deri në 14 mln lekë në vit dhe 15% për tatimpaguesit me të ardhura mbi 14 mln lekë në vit. Për personat juridikë, të cilët zhvillojnë veprimtari ekonomike sipas ligjit nr.38/2012, "Për shoqëritë e bash-

këpunimit bujqësor", shkalla e tatimit mbi fitimin është 5%. Për personat juridikë, të cilët zhvillojnë veprimtari agroturistike të certifikuar si "agroturizëm", bazuar në ligjin nr.93/2015, "Për turizmin" dhe vendimin e Këshillit të Ministrave që miraton kriteret për certifikimin e veprimtarisë së agroturizmit, shkalla e tatimit mbi fitimin është 5%. Norma e reduktuar e tatimit mbi fitimin 5%, e parashikuar sipas

këtij paragrafi, aplikohet për një periudhë 10-vjeçare për ato struktura, të cilat përfitojnë statusin "subjekt i certifikuar agroturizmi" deri në dhjetor 2021. Efektet e normës së reduktuar fillojnë në vitin pasardhës pas përfitimit të statusit "subjekt i certifikuar agroturizmi". Shkalla e reduktuar e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar 6 për qind aplikohet për furnizimin e shërbimit të akomodimit, restorantit, të of-



Komisioni i Ekonomisë

ruar brenda strukturave në të cilat zhvillohet veprimtari pritëse e certifikuar si "agroturizëm", sipas legjislacionit në fuqi në fushën e turizmit, me përjashtim të furnizimit të pijeve, të ofruar në këto struktura. Perso-

ni i tatueshëm, që aplikon shkallën e reduktuar të tatimit mbi vlerën e shtuar 6 për qind është personi i regjistruar me NIPT/NUIS, vetëm për zhvillimin e veprimtarisë pritëse të certifikuar si "agroturizëm".

Kreditë me probleme, masa shtrënguese për bankat që nuk bashkëpunojnë

Kreditë e këqija, rinegocim pas 60 ditë vonesë në pagesën e këstit

Banka e Shqipërisë nismë të re për uljen e huamarrjes me probleme

Ornela Manjani

Kredimarrësit që nuk shlyejnë brenda 60 ditëve këstin e kreditë do të kenë mundësinë të rinegociojnë termat, por kjo mund të realizohet vetëm me pëlqimin e bankës që ka dhënë huanë. Kjo është vetëm një pikat e rregullores së Bankës së Shqipërisë, e cila ka për qëllimin uljen e nivelit të kredive të këqija. Rregullorja parashikon që, për kredimarrësit më vonesë me mbi 60 ditë, bankat mund të nënshkruajnë marrëveshje bashkëpunimi për trajtimin e përbashkët të rastit. Pjesëmarrja e bankave në marrëveshje nuk është e detyrueshme, por rregullorja parashikon që Banka e Shqipërisë mund të ndërmarrë masa kufizuese ndaj atyre bankave që refuzojnë të bashkëpunojnë. Kredimarrësit që kanë ekspozim në më shumë se një bankë, për të paktën 100 milionë lekë do të jetë subjekt i rregullores së re të Bankës së Shqipërisë për trajtimin jashtëgjyqësor të klientëve në vështirësi financiare. Kjo rregullore do të jetë thelbi i qasjes së ashtuquajtur "Tirana Approach", që parashikon një kuadër për trajtimin e bashkërenduar të bizneseve që janë huamarrës në disa banka. Kështu, Banka e Shqipërisë mund të vendosë objektiva specifike për uljen e kredive me probleme ose të kërkojë një normë më të lartë të mjaftueshmërisë së kapitalit për bankat që nuk marrin pjesë në marrëveshje ose që pengojnë arrijtjen e objektivave të përbashkëta. Procesi i vendimmarrjes së përbashkët do të menaxhohet nga vetë bankat pjesëmarrëse, përmes strukturave të posaçme, mbledhjeve dhe shkëmbimit periodik të informacionit,



Banka e Shqipërisë

ndërsa Banka e Shqipërisë do të ketë një rol monitorues. Zgjidhjet që mund të ndërmerren në kuadrin e marrëveshjes do të jenë rristurimi i kredive, dhënia e financimeve shtesë për të forcuar qëndrueshmërinë e biznesit, përfshi këtu edhe konvertimin e borxhit në kapital, por edhe shitja e aseteve apo aktiviteteve të veçanta të biznesit debitor Rregullorja në fjalë do të ketë një kohëzgjatje dyvjeçare, deri në qershor 2020 dhe është hartuar kryesisht në funksion të menaxhimit të disa prej kredive ekzistuese problematike në segmentin e korporatave.

INSTITUCIONET FINANCIARE

Raporti i kredive me prob-

leme për institucionet financiare jo banka ishte 12% në fund të vitit të kaluar. Sipas të dhënave nga Banka e Shqipërisë, ky tregues ngeli i qëndrueshëm edhe për vitin e kaluar. Raporti i kredive me probleme ishte pothuajse në të njëjtin nivel krahasuar me një vit më parë dhe ngjelloi më i ulët në raport me sistemin bankar. Ndryshe nga sistemi bankar, institucionet financiare jo banka kanë një ritëm më të lartë të rritjes së portofolit të kreditë. Sipas Bankës së Shqipërisë, portofoli i kreditë së këtyre institucioneve u rrit me 16% gjatë vitit të kaluar. Rritja e kreditë së re ndihmon në mbajtjen nën kontroll të raportit të kredive me probleme, që his-

torikisht për institucionet financiare jo banka ka qenë më i ulët. Kjo lidhet kryesisht me tipologjinë e produkteve. Institucionet financiare jo banka japin kredi mesatarisht më të vogla krahasuar me bankat, të adresuara kryesisht të individët dhe bizneset e vegjël dhe mikro. Kjo iu mundëson një shpërndarje më të mirë të rrezikut kreditor. Të dhënat e Bankës së Shqipërisë tregojnë se për vitin e kaluar fitimi i institucioneve financiare jo banka arrii në rreth 1.16 miliardë lekë, në rënie të lehtë krahasuar me vitin 2016.

MFE dënon sulmin: Të angazhuar në betejën kundër informalitetit

Ditën e diel është shënuar një incident në zonën e Golemit gjatë një kontrolli të grupit të inspektorëve të Sektorit të Zbatimit, nga Drejtoria e Hetimit Tatimor. Gjatë ushtrimit të detyrës në një subjekt pranë "Pishave të Buta", tre inspektorët kontaktuan se subjekti ushtronte aktivitetin në fushën e shërbimit, pa lëshuar kupon tatimor. Mbi bazën e kësaj shkeljeje inspektorët e zbatimit informuan subjektin për penalizim me masën bllokim aktiviteti për 30 ditë kalendarike. Pas incidentit ka reaguar edhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë, e cila në një njoftim për shtyp shprehet se "dëshiron të përsërisë mesazhin e qartë se të gjithë strukturat tatimore të zbatimit dhe terrenit, mbeten të angazhuar për të vijuar zbatimin rigoroz të planit të masave për sezonin turistik.

United Nations Development Programme

VACANCY ANNOUNCEMENT

The United Nations Development Programme in Albania is looking for qualified candidates who could fill the following vacancies:

Posts Titles:

- 1- National Consultant – Trainer/Mentor, Self-employment
- 2- National Consultant – Team Leader/Trainer, Self-employment
- 3- National Consultant – Curricula Developer/Trainer, Self-employment

Type of Contract: Individual Contract

Project: Skills Development for Employment Programme

Job Station: Tirana, Albania

Deadline for Application: July 6, 2018

Job Description: <http://al.undp.org>

Qualified and interested candidates are requested to apply online via UNDP Albania website: <http://www.al.undp.org/content/albania/en/home/operations/jobs/>. Interested applicants are advised to carefully study all sections of this ToRs and ensure that they meet the general requirements as well as specific qualifications described. Incomplete applications will not be considered. Please make sure you have provided all requested materials. Qualified women and members of social minorities are encouraged to apply.

VETINGU SEANCA DEGJIMORE

Përpara KPK-së për t'u njohur me rezultatet e verifikimit. Zbulohen deklaratimet për periudhën 2003-2017

Vetingu, në 'sitë' Prokurorja e Përgjithshme Arta Marku, zbardhet skeda e pasurisë

Pasuria familjare kap vlerën e 5.4 milionë lekëve

Prokurorja e Përgjithshme e Shqipërisë, Arta Marku do t'i nënshtrohet procesit të vetingut. Seanca e KPK-së do të mbahet ditën e sotme, ndërkohe, trupa gjyquese përbëhet nga Genta Tafa (Bungo), Pamela Qirko, Suela Zhegu. Arta Marku i nënshtrohet vetingut me përparësi për shkak të detyrës që mban si kryeprokurore e përkohshme ndërkohe që para se të merrte këtë detyrë, dha dorëheqjen nga kandidimi për në Këshillin e Lartë të Prokurorisë. Marku u zgjodh Prokurore e Përgjithshme e Përkohshme në një seancë të tensionuar parlamentare në dhjetor 2017, kur deputetët e opozitës hodhën tymuese në shenjë proteste ndaj mënyrës së zgjedhjes së saj. 42-vjeçarja që punonte deri në atë kohë si zv.drejtuese e Prokurorisë së Shkodrës u ngjiti në postin më të lartë të akuzës vetëm me votat e mazhorancës, pas 17 vitesh karrierë në sistemin e drejtësisë. Në rast se KPK e konfirmon në detyrë Arta Markun, asaj i lind e drejta për t'u zgjedhur si drejtuese e organit të akuzës me një mandat të plotë 7-vjeçar sipas ligjeve të reja të reformës në drejtësi. Marku do të dalë para Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, organit bazë të Vetingut, për t'u njohur me rezultatet e hetimit të thelluar për ligjshmërinë e pasurisë, kontaktet e mundshme me botën e kirit dhe aftësitë profesionale. Pra, analiza e pasurisë është një ndër tre shtyllat e rivlerësimit, së bashku me kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale. 'Birn' paraqet ndryshimin e pasurisë së deklaruar të prokurores Arta Marku nga viti 2003 deri në fund të vitit 2017.

PASURIA
Të dhënat e analizuar nga BIRN tregojnë se Prokurorja e Përgjithshme e Përkohshme, Arta Marku nuk zotëronte asnjë pasuri në vitin 2003-viti i parë i deklaramit të pasurisë për zyrtarët e lartë. Ndërsa në fund të vitit 2017, pasuria familjare e znj. Marku kap vlerën e 5.4 milionë lekëve. Pjesa kryesore në ndryshimin e pasurisë përbëhet nga një apartament me sipërfaqe 103 metër katrorë në qytetin e



Prokurorja e Përgjithshme e Shqipërisë, Arta Marku

Shkodrës, i blerë së bashku me bashkëshortin për 5 milionë lekë në vitin 2006. Burimi i kësaj pasurie, sipas deklaramit është një

kredi bankare me vlerë 6.7 milionë lekëve. Përveç kredisë për shtëpinë, Marku ka marrë edhe kredi konsumatore përgjatë viteve

dhe një pjesë e kursimeve familjare kanë shkuar për shlyerjen e tyre. Në fund të vitit 2017, ajo zotëronte, gjithashtu, 450 mijë lekë

kursime në cash. Të ardhurat e familjes Marku përbëhen kryesisht nga të ardhurat e saj dhe të bashkëshortit, të cilat kapin në

total vlerën e 25.6 milionë lekëve për vitet 2003-2017. Ajo ka deklaruar, gjithashtu, të ardhura nga mësimdhënia në masën 1.3 për qind si dhe nga dietat rreth 1.5 për qind. Përveç analizës për rritjen/uljen e pasurisë, strukturën e aseteve dhe të ardhurave, ky raport paraqet dhe kontrollin aritmetik/logjik të deklaramit të subjektit si dhe "flamujt e kuq" që identifikohen gjatë kontrollit. BIRN kreu kontrollin aritmetik/logjik mbi 14 deklaramit pasurie të prokurores Arta Marku dhe asnjëra prej tyre nuk rezultoi me probleme apo me diferenca të pajustificuara.

Ndërkohe, 'BIRN' ka identifikuar si "flamur të kuq" në këtë analizë deklaramin e pronësisë së ¼ të një apartamenti nga bashkëshorti i saj në vitin 2015, pasuri kjo që nuk ishte deklaruar në vitet e mëparshme. Duke qenë se ky raport bazohet në të dhëna statistikore të analizuar nëpërmjet një databaze, ai nuk nxjerr përfundime mbi pasurinë e subjektit nëse ajo mbulohet me burime të ligjshme ose jo, por mëton të informojë publikun mbi pasurinë e deklaruar të zyrtarit publik.

KARRIERA

Marku u zgjodh Prokurore e Përgjithshme e Përkohshme në një seancë të tensionuar parlamentare në dhjetor 2017, kur deputetët e opozitës hodhën tymuese në shenjë proteste ndaj mënyrës së zgjedhjes së saj. 42-vjeçarja që punonte deri në atë kohë si zv.drejtuese e Prokurorisë së Shkodrës u ngjiti në postin më të lartë të akuzës vetëm me votat e mazhorancës, pas 17 vitesh karrierë në sistemin e drejtësisë.

TË ARDHURAT

Në fund të vitit 2017, pasuria familjare e znj. Marku kap vlerën e 5.4 milionë lekëve. Pjesa kryesore në ndryshimin e pasurisë përbëhet nga një apartament me sipërfaqe 103 metër katrorë në qytetin e Shkodrës, i blerë së bashku me bashkëshortin për 5 milionë lekë në vitin 2006.

Seanca dëgjimore, gjyqtari shfaq probleme me justifikimin e pasurisë

Kërkoj përjashtimin e trupës së vetingut, KPK rrëzon kërkesën e Artan Lazes

Komisioni i Pavarur të Kualifikimit rrëzoi ditën e djeshme kërkesën e gjyqtarit të Gjykatës së Tiranës, Artan Laze, për përjashtimin e trupës që do shqyrtojë dosjen e tij në kuadër të vetingut. Kërkesa për përjashtimin e trupës gjyquese erdhi nga gjyqtari Artan Laze seancës e shkuar me pretendimin se ishin treguar të njëanshëm. Konkretisht Laze u shpreh se trupa e KPK e ka hetuar atë vetëm në një nga shtyllat e rivlerësimit, atë të pasurisë. Pas rrëzimit të kërkesës për përjashtimin e trupës, KPK ka vijuar seancën dëgjimore për gjyqtarin. Sipas KPK-së nga verifikimi i ILDKPKI dhe i vetë komisionit ka rezul-

tuar se gjyqtari ka probleme me justifikimin e pasurisë. "Gjyqtari ka një apartament në Vlorë, një në Tiranë në rrugën e 'Kosovarëve' 158 m², një në rrugën e Durrësit 120 m², një në Bulqizë, tokë kullotë në Porto Palermo në vlerën 200 mijë lekë, një makinë tip 'Benz' të blerë nga KQZ. Lidhur me apartamentin 158 m² në Tiranë, përfutur në 2010 me vlerë 129 mijë euro nuk është deklaruar në 2010, por në 2011. Apartamenti është deklaruar 120 mijë euro dhe jo 129 mijë euro. Në 2011 gjyqtari ka deklaruar se burimi i pagesës së 129 mijë euro ishin të ardhura nga shitja e një tjetër apartamenti. Më 18.5.2010 gjyqtari Artan Laze ka derdhur 50 mijë euro për 'Orion shpk'. Gjyqtari kanë bërë i ka thënë janë

burim nga emigracioni, por nuk është në deklaratën e vitit 2009. Në deklaratën e 2009 gjyqtari ka thënë vetëm 5 mijë euro cash nga shitja e një makine. Për sa i përket apartamentit 120 m² tek Rruga e Durrësit, në deklaratën e vetingut gjyqtari thotë e ka blerë në 2004 dhe e ka shitur në 2010. Në 2004 është blerë 4 milionë lekë sipas kontratës noteriale dhe jo 53 mijë euro sikur është shkruar në deklaramin e vitit 2004. Sipas kontratës së shitjes të këtij apartamenti. Në 2010 është 90 mijë euro dhe jo 8 milionë sikur është deklaruar. Gjyqtari ka bërë kontratë noteriale fiktive. Gjyqtari ka kryer pagesa për 'albanian college' për shkollimin e vajzës. Por si ka pasqyruar asnjëherë në deklaratat. 10 mijë e 280 euro

shuma totale e paguar deri shkollën", deklaroi KPK. Pas leximit të relacionit mbi hetimet, ka reaguar gjyqtari Laze duke fajësuar ILDKPKI për pasaktësitë dhe bankën se ka gënjer. "ILDKPKI ka pasur detyrë të më kontrollonte. Pse nuk më ka kontrolluar kaq vite? ILDKPKI ka bërë shpërdorim detyrës përshirë kryesinspektorin. Raportet e ILDKPKI kanë kontradikta, njëherë thotë që nuk kam kryer fshehtë pasurie dhe njëherë, që kam deklarim të euro. Ka gënjer banka, sepse në mandat është bosh" u shpreh Artan Laze. Vendi-min nëse do të rikonfirmohet ose jo në detyrë gjyqtari Artan Laze, Komisioni i Pavarur të Kualifikimit do ta japë në datë 11 korrik.

Policia italiane ka shkatërruar një bandë të rrezikshme në Palermo që merrej kryesisht me trafikimin e qenieve njerëzore dhe armëve nga Ballkani. Në pranga përfunduan 17 persona dhe sipas mediave italiane, organizata kriminale kishte lidhje me Cosa Nostrën dhe grupin paraushtarak shqiptar të UÇK, të lidhur me qarqet xhihdaiste. Mësohet se shumica prej të arrestuarve janë shqiptarë të Kosovës dhe Maqedonisë. Konkretisht karabinierët kanë ndaluar shtetasit Fatmir Ljatifi, Driton Rexhepi, Arben Rexhepi, Xhemshii Versheveci, Franco Mapelli, Tiziano Moreno Mapelli, Salvatore Morello, Gabriele Torres, Dario Vitellaro, Luan Dob-

Shkatërrohet grupi kriminal, kishte lidhje me UÇK-në

Trafikonin armë, diamante e emigrantë nga Ballkani, bien në pranga 17 persona

AKUZA

Pjesëtarët e këtij grupi kriminal akuzohen se bëjnë pjesë në një grupim kriminal ndërkombëtar që merrej me emigracion klandestin, trafik të armëve të luftë dhe riciklimin e diamanteve, floririt dhe parave. Banda menaxhonte udhëtimet e emigrantëve në itinerarin ballkanik. Përmes Italisë, dhjetëra persona kanë tentuar të shkonin drejt Zvicrës dhe veriu të Europës.

jani, Ibraim Latifi, Jenia Fele Arena, Giuseppe Giangrosso, Djemilj Djaferi, Denis Niki, Urran Ameti, Francesco Tinnirello, Salvatore Morello, Gabriele Torres, Dario Vitellaro, Luan Dobjani. Ata akuzohen se bëjnë pjesë në

një grupim kriminal ndërkombëtar që merrej me emigracion klandestin, trafik të armëve të luftë dhe riciklimin e diamanteve, floririt dhe parave. Banda menaxhonte udhëtimet e emigrantëve në itinerarin ballkanik. Përmes Italisë, dhjetëra persona kanë tentuar të shkonin drejt Zvicrës dhe veriu të Europës. Përveç Italisë dhe Zvicrës, organizata kriminale ka zhvilluar aktivitetin e saj në Gjermani, Maqedoni dhe Kosovë. Banda ishte



Të arrestuarit

e ndarë në dy grupe, njëri përbëhej nga shtetas kosovarë dhe tjetri nga italianë dhe maqedonas. Mësohet se në krye ishte maqedonasi Fatmir Ljatifi, një italian nga Palermo Giuseppe Giangrosso dhe kosovari Driton Rexhepi. Përmes Italisë dh-

jetëra persona, falë këtij grupi kriminal janë përpjekur që të shkojnë në Zvicër dhe në Europën Veriore. Mësohet se refugjatët transportoheshin për në Zvicër me makinë. Për këtë shërbim, emigrantët paguanin 3 mijë euro.

Hetimet përqendrohen te motivet e ngjarjes. Kolegët: Nuk e kemi parë të shqetësuar

TABULATET TELEFONIKE

Nga këqyrja e tabulateve telefonike mësohet se 31-vjeçari Qordja i ka dërguar një mesazh të shkurtër nënës së tij para ngjarjes ku i kërkoi falje. Ky komunikim sipas hetuesve konfirmoi dyshimet e tyre se Qordja ka qëlluar mbi veten. Grupi hetimor ka sekuestruar telefonin e

Tabulatet telefonike, zbardhet mesazhi i fundit i gardistit Shkëlzen Qordja

Para vetëvrasjes 31-vjeçari i shkruan nënës "Më fal"

Dy ditë pas vdekjes së gardistit Shkëlzen Qordja, i cili ishte dhe shoferi i ministrit të Brendshëm, Fatmir Xhafaj të tjera detaje dalin në dritë. Nga këqyrja e tabulateve telefonike mësohet se 31-vjeçari i ka dërguar një mesazh të shkurtër nënës së tij para ngjarjes ku i kërkoi falje. Ky komunikim sipas hetuesve konfirmoi dyshimet e tyre se Qordja ka qëlluar mbi veten. Grupi hetimor ka sekuestruar telefonin e viktimës për të verifikuar të gjitha komunikimet që ai ka pasur para se të gjendej pa jetë. Ndërkohë ekspertiza paraprake ka konfirmuar vetëvrasjen e gardistit. Mjekët ligjorë kanë konstatuar se vdekja ka ardhur nga një plumb në anën e djathtë të kokës. Ekspertët kriminalistikë kanë konstatuar, gjithashtu, faktorë plotësues të qitjes me armë zjarri në dorën e tij të djathtë. Edhe gjurmët e gish-tërinjve në armën automatike tip MP5 përputhen me ato të 31-vjeçarit. Megjithatë deri tani ende nuk është përcaktuar motivi i kësaj ngjarjeje, për të cilën po vijojnë hetimet. Grupi hetimor është duke punuar për të qartësuar shkaqet e ngjarjes dhe zbardhjen e rrethanave. Mësohet se hetuesit e çështjes kanë sekuestruar kamerat e sigurisë së Gardës së Republikës. Kolegët e 31-vjeçarit janë shprehur se nuk e kanë parë të shqetësuar ditët e fundit. Miqtë e njohin si njeri të qetë punëtor, pa vese dhe që nuk kishte probleme. Ata thonë se nuk kanë dalluar asgjë që nuk shkoste kohët e fundit tek ai. Po ashtu 31-vjeçari rezultoi se pak orë para se të parkonte automjetin ku



31-vjeçari, Shkëlzen Qordja

u vetëvra në mjediset e gardës, ka qenë duke festuar në një nga klubet e natës në kryeqytet. Ky version konfirmohet edhe nga të afërm të 31-vjeçarit, i cili sipas tyre kishte postuar edhe video në rrjetet sociale. "Një djalë të shkëlqyer, një punonjës i papërtuar dhe fjalëpakë", kështu e përshkroi 31-vjeçarin ministri Fatmir Xhafaj, duke theksuar se nuk gjente dot fjalë për të ngushëlluar familjen Qordja. Menjëherë pas ngjarjes reagoi nëpërmjet një njoftimi për mediat edhe Garda e Republikës. "Ditën e shtunë rreth orës 09:30 të mëngjesit, në garnizonin e Gardës së Republikës është gjetur i pajetë brenda garazhit, të caktuar për mjetet e Ministrisë së Brendshme, gardisti me detyrë funksionale shoferi i ministrit të Brendshëm, Shkëlzen Qordja, 31 vjeç. Trupi i pajetë u

konstatua nga punonjës të Gardës. Grupi hetimor nën drejtimin e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë është duke punuar për të qartësuar shkaqet e ngjarjes dhe zbardhjen e rrethanave", thuhej në njoftim. Gardisti Shkëlzen Qordja u përcoll të dielën në mesditë në banesën e fundit. Qordja punonte prej kohësh si shofer i ministrit të Brendshëm Fatmir Xhafaj. Ai kishte nisur punë në Gardën e Republikës në mars të vitit 2017 dhe nuk kishte qenë asnjëherë subjekt procedimi, pezullimi apo mase tjetër disiplinore.

SHKURTE

U aksidentuar teksa ecte në rrugë, 5-vjeçarja ndërroi jetë në spitalin e Traumës

Ka ndërëruar jetë në spitalin e Traumës në Tiranë, 5-vjeçarja, e cila u aksidentua dy ditë më parë nga një automjet teksa ecte në rrugë. Mësohet se bëhet fjalë për Afisela M.. Mësohet se si pasojë e goditjes nga automjeti, vogëlushja pësoi hemorragji në tru dhe nuk mundi të mbijetonte. Ndërkohë, policia shqërooi në komisariat drejtuesin e mjetit tip "Ford", 41-vjeçarin Leonard Abedinaj.

Rrëzohet nga kati i pestë i pallatit, përfundon në spital 50-vjeçari në Tiranë

Një 50-vjeçar nga Tirana është rrëzuar aksidental isht nga kati i 5-të i pallatit. Ngjarja ndodhi sot në rrugën "Margarita Tutulani". Burime zyrtare nga policia bënë me dije se bëhet fjalë për shtetasin me inicialet L.L. Aktualisht i plagosuri ndodhet në spital. Nuk dihet ende gjendja e tij shëndetësore.

HETIMI



Ndërtoi pa leje në tokë publike në Borsh, arrestohet 45-vjeçari nga Tirana

Një 45-vjeçar ndërtesues nga Tirana u zbulua nga strukturat e Hetimit të Krimeve se kishte ndërëruar pa leje në tokë publike në Borsh. Strukturat Policore për Hetimin e Krimeve në Komisariatin e Policisë Himarë kanë arrestuar shtetasin: Themistokli D., 45 vjeç, banues në Tiranë. U krye arrestimi i tij pasi gjatë kontrollit

të territorit me qëllim evidentimin dhe goditjen e paligjshmërisë në fshatin Borsh është konstatuar se ka kryer ndërëtim të paligjshëm në tokë publike. Materialet hetimore iu referuan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë, për veprën penale "Ndërëtim i paligjshëm" parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal.

"Kërkoj mëshirë për tim bir, të mos e torturojnë se është budalla!"

Vodhi dyqanin e lagjes, 50-vjeçari sulmon e plagos me gërshërë 3 efektivë

ELBASAN

Tre efektivë të policisë së Elbasanit kanë mbetur të plagosur, teksa tentuan të arrestojnë një 50-vjeçar, autor i vjedhjes së një dyqani. Mësohet se Irfan Halimllari, banor i komunitetit rom ka kërcënuar dhe i ka marrë një shumë parash pronarit të një dyqani dhe më pas është kthyer në shtëpi. Menjëherë pronari i lokalit ka njoftuar policinë, e cila ka shkuar në banesën e autorit për ta arrestuar. Por, 50-vjeçari iu është bluve me dhunë. Ai ka marrë një palë gërshërë dhe ka goditur mbi efektivët e policisë, të cilët morën ndihmë mjekësore në spital. Pas përlëshjes, autori i krimit është vënë në pranga dhe është dërguar në paraburgimin e Komisarariatit të Elbasanit. Ngjarja ka ndodhur paraditen e djeshme në lagjen "5 Maj" të këtij qyteti. Ndërkaq, në lidhje me ngjarjen ka reaguar nëna e 50-vjeçarit, e cila ka deklaruar se ishin policët që dhunuan të parët djalin. "E shtrinë katër veta për tokë. E lidhën, e goditën, ndërsa gjaku shkante lumë. Im bir ka ikur nga mendja që para një jave. Ai vuan nga probleme mendore, ndaj kërkoj mëshirë për të", tha nëna e 50-vjeçarit të arrestuar.

NGJARJA

Rreth orës 10:00 të ditës së djeshme, Irfan Halimllari ka shkuar në dyqanin e lagjes ku banonte (vetëm pak metra larg shtëpisë së tij) dhe nëpërmjet kërcënimit ka marrë 20 mijë lekë të reja të xhros ditore. Pas terrorit në dyqan, pronari Ardian Kuka ka njoftuar policinë për ngjarjen. Tre punonjës policie, mes të cilëve dhe komandanti i shërbimit Ajet Celibashi kanë shkuar në shtëpinë e grabitësit për ta arrestuar, por ky i fundit jo vetëm ka rezistuar, por i ka sulmuar me një palë gërshërë tre efektivët duke i lënë të plagosur. Mësohet se njëri nga policët është plagosur me gërshërë në qafë. Pas disa minutash përlëshje, policët e kanë neutralizuar dhe e kanë vënë në pranga autorin e sulmit, i cili akuzohet për veprat penale: "Vjedhje" dhe "plagosje e lehtë e punonjësve të policisë". Pas ngjarjes, "Gazeta Shqiptare" ka shkuar në banesën e Halimllarit. E pyetur në lidhje me ngjarjen, nëna e 50-vjeçarit u shpreh se djali i saj vuan nga probleme mendore.

DËSHMIA E NËNËS

"Unë isha në punë dhe erdha me vonesë. Më duket se djalin e goditën të parët policët. E shtrinë, e lidhën dhe gjaku shkante lumë. Ishin katër veta që e shtrinë



Nëna e 50-vjeçarit Irfan Halimllari, duke folur për "GSH"



Efektiv i plagosur Ajet Celibashi

në tokë dhe e goditën. Im bir nuk ka pasur armë të ftohtë, por policët i ka goditur me gërshërë, me të cilat po punonte, shportat, kanistrat. Ai ka një javë që ka kaluar nga mendët. Ka një javë pa drita. Është gjynah të më torturojnë djalin, pasi është budalla, është një njeri me të meta mendore", tha nëna e 50-vjeçarit Irfan Halimllari. Ndërkaq, e moshuara u shpreh se policët e dinin se i biri kishte probleme mendore dhe pavarësisht kësaj i thanë se do të vrasim me pistoletë. "Djali nuk ka qenë mirë mendërisht ndaj ka shkuar e ka vjedhur në dyqan. Në kemi kaq vjet që hamë në atë dyqan. Po të ishte mirë nga mendët e kokës, ai nuk e kish të bërë atë veprim. Shikoni ku jeton djali, në shtëpinë që para një viti ia ndërtoi shtë-

ti. Ai jeton I vetëm. Kanë shtëpi ata policët apo jo. Gjynah që më goditën djalin. Kërkoj mëshirë për të", pohoi nëna e 50-vjeçarit.




Shtëpia e familjes Halimllari, ku ndodhi ngjarja

PLAGOSJA E POLICËVE

Tre punonjës policie, mes të cilëve dhe komandanti i shërbimit Ajet Celibashi kanë shkuar në shtëpinë e grabitësit për ta arrestuar, por ky i fundit jo vetëm ka rezistuar, por i ka sulmuar me një palë gërshërë tre efektivët duke i lënë të plagosur. Mësohet se njëri nga policët është plagosur me gërshërë në qafë. Pas disa minutash përlëshje, policët e kanë neutralizuar dhe e kanë vënë në pranga autorin e sulmit, i cili akuzohet për veprat penale: "Vjedhje" dhe "plagosje e lehtë e punonjësve të policisë".

AKUZAT NDAJ POLICËVE

"Im bir nuk ka pasur armë të ftohtë, por policët i ka goditur me gërshërë, me të cilat po punonte, shportat, kanistrat. Ai ka një javë që ka kaluar nga mendët. Ka një javë pa drita. Është gjynah të më torturojnë djalin, pasi është budalla, është një njeri me të meta mendore. Policët e dinin se djali kishte probleme mendore dhe pavarësisht kësaj i thanë se do të vrasim me pistoletë", tha nëna e 50-vjeçarit Irfan Halimllari.



Goditi 27 herë me thikë kuzhinierin italian, mbyllën hetimet për të riun shqiptar

ITALI - Prokuroria e Imperias ka mbyllur hetimet për vrasjen e kuzhinierit italian Alfio Fallica. Ngjarja në fjalë ndodhi më 24 shkurt të vitit të kaluar, në restorantin "Pulcinella" në Montecarlo. Siç shkruajnë mediat italiane, autori i krimit është kolegu i tij, shqiptari Rikard Nika, 32 vjeç, i cili prej 20 vitesh jeton në Itali. 'La Riviera' shkruan se nga hetimet e kryera nga organi i akuzës rezultoi se shqiptari ka vrarë me paramendim kolegun e tij, për motive banale, ndërsa e ka goditur me thikë 27 herë, mes të cilave 8 në qafë, 6 në duar dhe parakrahë. Aktualisht, shqiptari ndodhet në burg dhe Genoa.

FIER



Kanosin punonjësien e karburantit dhe i vjedhin xhiron ditore, në kërkim dy autorët

Dy persona të paidentifikuar kanë vjedhur një pikë karburanti në Levan të Fierit. Ngjarja ndodhi në orët e para të mëngjesit të djeshëm. Burime zyrtare nga policia bënë me dije se ka qenë punonjësi i karburantit që deklaroi se përmes kërcënimit autorët i kanë marrë xhiron ditore. Të njëjtat burime thanë se autorët kanë vjedhur rreth 30.000 lekë dhe më pas janë larguar në drejtim të Fierit me një mjet tip "Fiat". "Në datën 02.07.2018, rreth orës

04:40, në fshatin Levan, Fier, shtetasi T.S., punonjës në një pikë karburanti ka njoftuar se 2 të rinj, e kanë kanosur dhe i kanë marrë xhiron e natës, rreth 30.000 lekë dhe më pas janë larguar në drejtim të Fierit me një mjet tip "Fiat". Shërbimet e Policisë kanë ngritur pika të shumta kontrolli. Grupi hetimor po kryen veprimet për sqarimin e rrethanave të ngjarjes, identifikimin dhe kapjen e autorëve", -thuhet në njoftimin zyrtar të policisë.



Eksploziv në banesën e policit të burgjeve, banorët sinjalizojnë në kohë policinë

KRUJË - Një sasi eksplozivi është vendosur në banesën e një punonjësi të policisë së burgjeve në Fushë-Krujë. Mësohet se fatmirësisht lënda plasë se nuk ka shpërthyer, pasi është pikasur nga banorët, të cilët menjë herë kanë

lajmëruar policinë. Ngjarja ka ndodhur gjatë natës të së premtes që shkoi në banesën e 52-vjeçarit me inicialet I.D. në fshatin Bubq. Menjëherë në vendngjarje kanë shkuar uniformat blu, të cilët kanë nisur hetimet për identifikimin

dhe vënien në pranga të autorit të krimit, ndërsa është marrë edhe dëshmia e policit. Nuk dihet nëse ngjarja ka lidhje me detyrën apo me ndonjë konflikt tjetër. Materialet i kaluan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Krujë për vepr

time të mëtejshme për veprat penale: "Shkatërrimi i pronës me eksploziv" i mbetur në tentativë dhe "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarakë dhe e municionit". Ndërkaq, mësohet se të njëjtit efektiv policie i është vënë eksploziv dhe para disa viteve. Në kohë n kur ka ndodhur ngjarja, lënda plasëse ka shpërthyer, por fatmirësisht ka shkakuar vetëm dëme materiale.

Dyshojmë se ngjarja ka ndodhur për motive konkurrence, ka pasur ndërhyrje

Klodiana Haxhija

DURRËS

Agron Kryeziu, i cili u arrestua nga policia për kallëpet e tritolit nuk është menaxher i fabrikës së plastikës. Ai është punëtor i thjeshtë si ne. Nuk besojmë se ai ka lidhje me ngjarjen. Dyshojmë se ngjarja mund të ketë marrë shkas për motive konkurrence". Kështu u shprehën dje punëtorët e fabrikës së plastikës "Group Compozites" në Porto Romano të Durrësit, ku mesditën e së shtunës u sekuestruan katër kallëpe tritolit të lidhura me kapsolla të montuara. 25-punonjësit thanë për "Gazeta Shqiptare" se janë të shokuar nga ngjarja. Ndërkohë, ditën e djeshme fabrika, e cila ka nisur punën 7 muaj më parë ka funksionuar normalisht. Kjo fabrikë, e cila gjendet në Porto Romano në një sipërfaqe të madhe është investim italian, ndërsa policia e gjetit bregdetar ka shpallur në kërkim edhe pronarin. Bëhet fjalë për 43-vjeçarin E.B., shtetas italian.

DËSHMIA E PUNËTORËVE

Sipas punëtorëve, në këtë fabrikë prodhohen materiale plastike, kryesisht lodra që përdoren në parqet për fëmijë. "Gazeta Shqiptare" dje ishte brenda fabrikës ku punohej pa ndërprerje në disa sektorë që nga veshja, lyerja, tharja e procese të ndryshme të profileve të plastikës. Të punësuarit ishin kryesisht djem e vajza të reja nga 20 deri në 35 vjeç. Ata u shprehën se ngjarja ndodhi rreth orës 12:00 të së shtunës që shkoi. "Disa punonjës policie civile hynë në ambientet e fabrikës dhe na mblodhën të gjithëve në punëtorëve në një prej ambienteve, ndërsa na kërkuan që të limim punën. Më pas inspektorët e policisë kontrolluan ambientet e fabrikës. Ne nuk morëm vesh asgjë se çfarë po ndodhte dhe se çfarë kishin gjetur. Policët na kërkuan disa shishe për marrë mostra nga materialet që përdoren aty për ngjitje e stukim apo lyerje të plastikës. Nuk na thane asgjë. Vetëm të nesërmen dëgjuan në televizor që kishin gjetur kallëpe tritolit. Mbetëm të çuditur, pasi nuk na besojë. Ata arrestuan shokun tonë që vjen në punë për çdo ditë nga Ndro-

Tritol dhe kapsolla në fabrikën e plastikës, punëtorët: Kolegu ynë është i pafajshëm

"Agron Kryeziu nuk është menaxher dhe nuk ka gisht në ngjarje, policia ta lërë të lirë"



Fabrika e plastikës në Durrës



KALLËPET ME TRITOL

Gjatë kontrollit të ushtruar në fabrikën "Group Compozites" në Porto Romano të Durrësit, e cila merret me prodhimin e profileve plastike, në një kovë plastike me bojë kanë gjetur dhe sekuestruar 4 pako të mbështjella me lëndë plasëse të dyshuar tritol, ku secila pako ishte e lidhur me dy fije teli të veshura dhe me kapsolla të montuara.

qi. Policia tha që ai është menaxheri i fabrikës. Nuk është aspak e vërtetë, pasi Agron është një prej punonjësve, si puna jonë që jemi këtu. Nuk e besojmë se është i përfshirë në këtë ngjarje. Ai është i urtë, i sjellshëm e punëtor. Është i pafajshëm. Më mirë të na arrestojnë ne dhe ta lirojnë atë", u shprehën punëtorët e fabrikës së plastikës në Porto Romano. Ndërkaq, ata pohuan se dyshojnë që ngjarja mund të ketë marrë shkas nga konkurrenca. "Ka 7 muaj që është hapur kjo fabrikë dhe kanë qenë të shumta ndërhyrjet", thanë ata.

NGJARJA

Specialistët kundër trafikëve në Drejtorinë Vendore të Policisë Durrës, në bazë të informacioneve të siguruar nga rrugë operative, kanë goditur një rast

trafikimi të armëve dhe municioneve. Gjatë operacionit policor të zhvilluar mesditën e së shtunës janë sekuestruar pako të dyshuara me lëndë tritol. Gjatë kontrollit të ushtruar në kompaninë private, e cila merret me prodhimin e profileve plastike, në një kovë plastike me bojë kanë gjetur dhe sekuestruar 4 pako të mbështjella me lëndë plasëse të dyshuar tritol, ku secila pako ishte e lidhur me dy fije teli të veshura dhe me kapsolla të montuara. Në bazë të këtij operacioni u bënë e mundur arrestimi në flagrancë i menaxherit të firmës, shtetasit Agron Kryeziu, 28 vjeç, banues në Durrës. Gjithashtu, është shpallur në kërkim dhe po punohet për kapjen e pronarit të kompanisë, shtetasi italian E.B. 43 vjeç. Ndërkohë po punohet për

ARRESTIMI

Policia e Durrësit ka arrestuar në flagrancë menaxherin e firmës, shtetasin Agron Kryeziu, 28 vjeç, banues në Durrës. Gjithashtu, është shpallur në kërkim dhe po punohet për kapjen e pronarit të kompanisë, shtetasi italian E.B. 43 vjeç. Materialet i kaluan prokurorisë së Durrësit për veprat penale: "Trafikimi i armëve dhe i municionit", "Fshehja e të ardhurave" dhe "Punësimi i paligjshëm".

sqarimin e rrethanave të tjera të veprës penale dhe personave të tjerë të përfshirë në këtë aktivitet kriminal. Materialet i kaluan Prokurorisë së Rrethit

Gjyqësor Durrës për veprime të mëtejshme për veprat penale: "Trafikimi i armëve dhe i municionit", "Fshehja e të ardhurave" dhe "Punësimi i paligjshëm".

Ndërtoi pa leje në tokë publike në Bors, arrestohet

45-vjeçari nga Tirana

HIMARË - Një 45-vjeçar, ndërtues nga Tirana ka përfunduar në pranga, pasi ka ndërtuar pa leje në tokë publike në Bors. Strukturat Policore për Hetimin e Krimeve në Komisarariat dhe Policisë Himarë kanë arrestuar shtetasin: Themistokli D., banues në kryeqytet. Mësohet, se ai u kap, pasi gjatë kontrollit të territorit me qëllim identifikimin dhe goditjen e paligjshmërisë në fshatin Bors është konstatuar se ka kryer ndërtim të paligjshëm në tokë publike. Materialet hetimore iu referuan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë, për veprën penale "Ndërtim i paligjshëm", parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal.

LEZHË

Rrugorët në aksion, prangosen 4 drejtues mjetesh, vendosim 647 masa administrative

Policia Rrugore e Lezhës në kuadër të masave për rritjen e sigurisë ka ndëshkuar me gjoba dhe ka vënë në pranga disa drejtues automjetesh. Burime zyrtare dje bënë me dije se në funksion të këtyre kontrolleve, janë

arrestuar katër shoferë për "Drejtim mjetei në mënyrë të parregullit" (të pa pajisur me leje drejtimi). Ndërkohë, janë vendosur 647 masa administrative për shkelje të ndryshme të Kodit Rrugor. Mësohet se janë ndaluar administrativisht 10 mjete, të

cilat kanë rezultuar me detyrime administrative të pashlyera. Policia Rrugore e Lezhës deklaroi se do të vijojnë kontrollimet me qëllim parandalimin e aksidenteve rrugore dhe rritjen e parametrave të sigurisë rrugore.

ARSIMI PARAUNIVERSITAR PROBLEMATIKAT



ORË TË PAPAGUARA

"Dua të theksoj se normat e punës, udhëzimi 44, nuk respektohet. Kështu klasa kujdestari 2 orë mësimore nuk i njihet asnjë mësuesi në qytetin e Tiranës. Ndërsa 10 orët e SHQK (shkollës qendër komunitare), qëndrojnë të ngrira. Pra, orët suplementare nuk paguhen dhe mësuesit pretendojnë pagesë për korrigeimet dhe konsultimet për PL, punë ekstra, e cila është paguar disa vite më parë", thekson Lama.



MATURA SHTETËRORE

"Në Tiranë mendoj se monitorimi bëhet shumë i rregullt. Do të dëshiroja të bëhej edhe në rrethe kështu me qëllim që të gjithë nxënësit të marrin atë që meritojnë, pasi parregullsia penalizon më të mirët. Këtë vit pati pak pakënaqësi nga prindërit lidhur me ambientet e zhvillimit të testimeve, të cilat ishin në korridorët e shkollave", bën me dije kreu i Sindikatës së Pavarur të Arsimit për Tiranën.



ARSIMI FILLOR

"Krerët e sindikatës në shkolla janë bashkëpunues dhe mësues shumë profesionistë. Ata ndjekin zhvillimet, urdhrat, udhëzimet me shumë vëmendje. Mësuesit e arsimit fillor janë në pritje të ndryshimit të dispozitës 80 neni 124 të ligjit të Arsimit të Lartë, nen i cili ka fuqi prapavepruese për shkollimin dhe semestrat e shkollimit duke mos respektuar kurrikulat e shkollimit para sistemit të Bolonjës", thotë Lama.

Kryetarja e Sindikatës së Pavarur të Arsimit: Orët suplementare nuk paguhen

Mësuesit e parauniversitarit, 6 vjet pa shpërblimet e fundvitit

Voltiza Duro

Pëj 6 vitesh mësuesit e arsimit parauniversitar në vend, nuk po marrin shpërblimet e fundvitit, pavarësisht premtiveve të Ministrisë së Arsimit. Gjithashtu, orët suplementare për korrigeime apo konsultime, edhe pse janë paguar vite më parë, tashmë nuk kanë asnjë shpërblim shtesë. Në një intervistë për "Gazeta Shqiptare", Alma Lama, mësuese kimie, njëkohësisht edhe kryetare e Sindikatës së Pavarur të Arsimit për Tiranën, pjesë e SPASH, ngre të gjitha problematikat që shqetësojnë mësuesit e arsimit parauniversitar, duke përfshirë këtu edhe premtimin e pambajtur për rritjen e pagave me 40%. Gjithashtu, Lama thekson se për sa i përket procesit të Maturës Shtetërore 2018, në Tiranë monitorimi bëhet shumë i rregullt, por shprehet se kjo duhet të realizohet edhe në rrethe në mënyrë që nxënësit të marrin atë që meritojnë. Ndërkohë kryetarja e SPASH për Tiranën, bën me dije se është përfunduar dhe mësuesve e duhet të thirret nga DAR Tiranë në procesin e rekrutimit të mësuesve, për monitorim, në kuadër të cilës së arsimit dhe transparencës si partnere sociale. Por deri më tani nuk ka qenë e pranshme gjatë monitorimit mbi rekrutimin e mësuesve të rinj.

Alma Lama: Rritja e pagave, premtim i pambajtur

SHQK (shkollës qendër komunitare), qëndrojnë të ngrira. Pra, orët suplementare nuk paguhen dhe mësuesit pretendojnë pagesë për korrigeimet dhe konsultimet për PL, punë ekstra, e cila është paguar disa vite më parë. Gjithashtu, dua të bëj me dije se vlerësimi i kurrikulës me kompetenca, një punë shumë e mundimshme, teknikisht kërkon ndryshime në formatin e regjistrimit.

A i kemi shprehur pakënaqësitë tuaja pranë Ministrisë së Arsimit, lidhur me problematikat e sipërpërmendura?

Natyrisht që po! Kemi realizuar një takim në MASR dhe jemi shprehur për ndryshim. Drejtorja e Arsimit Parauniversitar në Ministrinë e Arsimit, Sportit e Rinisë, Zamira Gjini ishte udhëheqëse e këtij takimi. Ajo na premtoi një takim të dytë, por ne ende jemi në pritje.

Sa të kënaqur janë mësuesit e arsimit parauniversitar me pagat? A është rritur pagesa ashtu siç është premtuar disa muaj më parë?

Nuk jemi të kënaqur. Nuk është mbajtur premtimi. Gjatë fushatës kryeministri premtoi 40% rritje pagash, të cilën duhet ta ndante 10% çdo projekt / buxhet në fundvit. Presim një rritje sipas deklaratës së kryeministrit, këtë muaj, pra në korrik 2018.

Tashmë që është nënshkruar kontrata kolektive me Ministrinë e Arsimit, cilat janë përfitimet për mësuesit?



Alma Lama, kryetare e Sindikatës së Pavarur të Arsimit për Tiranën.

PAGAT

Nuk jemi të kënaqur. Nuk është mbajtur premtimi. Gjatë fushatës kryeministri premtoi 40% rritje pagash, të cilën duhet ta ndante 10% çdo projekt / buxhet në fundvit.

Presim një rritje sipas deklaratës së kryeministrit, këtë muaj, pra në korrik 2018.

Kontrata shprehet në disa nene për punësimin, kohën e punës, kushtet e punës, kohën e pushimit, zhvillimin e vazhduar profesional, sistemin e pagave dhe shpërblimeve, strategjitë, reformat dhe modernizimin e arsimit, angazhimin për braktisjen shkollore, liritë dhe të drejtat sindikale. Zbatimi i kontratës kolektive për ne sjell zgjidhjen e shumë mosmarrëveshjeve. Dua të thek-

soj se shumë i rëndësishëm është neni 18.2 ku marrëdhëniet MASR dhe FSASH/SPASH vazhdojnë të rregullohen deri në nënshkrimin e kontratës së re kolektive, risi në këtë kontratë kolektive të re. Nuk ka më peng kontratash!

Gjatë viteve të fundit, sa kanë mundur mësuesit të ndikojnë në vendimmarrjet lidhur me VKM-të apo udhëzimet e miratuara nga

KONTRATA KOLEKTIVE

Kontrata shprehet në disa nene për punësimin, kohën e punës, kushtet e punës, kohën e pushimit, zhvillimin e vazhduar profesional, sistemin e pagave dhe shpërblimeve, strategjitë, reformat dhe modernizimin e arsimit, angazhimin për braktisjen shkollore, liritë dhe të drejtat sindikale.

Ministria e Arsimit?

Mësuesit janë bërë më seriozë vitet e fundit. Unë personalisht kam kolegë që diskutojmë çështje dhe mendojmë zgjidhje të cilat i propozojmë institucioneve tona të varësisë. Krerët e sindikatës në shkolla janë bashkëpunues dhe mësues shumë profesionistë. Ata ndjekin zhvillimet, urdhrat, udhëzimet me shumë vëmendje. Vlen të përmendet ndryshimi i VKM.175. Mësuesit e arsimit fillor janë në pritje të ndryshimit të dispozitës 80 neni 124 të ligjit të Arsimit të Lartë, nen i cili ka fuqi prapavepruese për shkollimin dhe simestrat e shkollimit duke mos respektuar kurrikulat e shkollimit para sistemit të Bolonjës.

Një tjetër problematikë shqetësose për mësuesit

ka qenë fakti që nuk kanë marrë shpërblimet e fundvitit. A vazhdon ende ky shqetësim apo i është dhënë zgjidhje?

Nuk i kemi marrë që prej 6 vitesh. Përsëri në këtë kontratë të sapofirmosur në 05.06.2018 neni 10.12 flet për njohjen e të drejtës për shpërblim. Na del detyrë ta respektojmë, ne dhe MASR për shpërblimin dhe për çdo nen.

Cili është opinioni juaj si mësuese mbi mbarëvajtjen e procesit të Maturës Shtetërore 2018? A ka pasur parregullsi?

Në Tiranë mendoj se monitorimi bëhet shumë i rregullt. Do të dëshiroja të bëhej edhe në rrethe kështu me qëllim që të gjithë nxënësit të marrin atë që meritojnë, pasi parregullsia penalizon më të mirët. Këtë vit pati pak pakënaqësi nga prindërit lidhur me ambientet e zhvillimit të testimeve, të cilat ishin në korridorët e shkollave.

Sa i besueshëm është punësimi nëpërmjet portalit, sa gjen zbatueshmëri parimi i meritokracisë?

Unë si përfunduese e mësuesve sipas udhëzimit Nr:38 dt 06.10.2015 "Për procedurat e lëvizjes paralele, emërimit dhe largimit nga puna të mësuesit në institucionet arsimore publike të sistemit të APU" duhet të thirrem nga Dar Tiranë në procesin e rekrutimit të mësuesve, për monitorim, në kuadër të cilës së arsimit dhe transparencës si partnere sociale. Fakti që nuk e monitoroj nga afër këtë proces nuk mund të shprehem.

Kompleksi fantastik, destinacion kryesor për mijëra turistë nga brenda dhe jashtë vendit

Voltiza Duro

Prestige Resort", një prej komplekseve më të mrekullueshme e modern në vend, ka hapur dyert për drejtuesit e përgjithshëm të mediave publike në Europë e Azi. Por relaksim në këtë resort fantastik pranë detit Adriatik e kanë shijuar edhe drejtorët e mediave më të njohura ndërkombëtare si 'BBC', 'ZDF', 'RAI', televizioni publik francez 'ARD' si dhe shumë të tjerë. Kështu pas përfundimit të Asamblesë së 80 të Përgjithshme të EBU-së (Bashkimi i Transmetuesve Evropianë) që u zhvillua në Tiranë, drejtorët e mediave të sipërpërmendura zgjodhën të vizitonin disa vende në Shqipëri, ku nuk mund të mungonte 'Prestige Resort' në Golem, si një prej destinacioneve më të mira në Shqipëri. Bashkimi i Transmetuesve Evropiane-EBU është aleanca drejtuese në rang botëror e shërbimit të medias publike, e cila ka 73 anëtarë në 56-të vende në Evropë dhe 33 anëtarë të asociuar në Azi, Afrikë dhe Amerikë.


Drejtori i marrëdhënieve me jashtë në RTSH, Kleart Duraj shoqëroi drejtorët e mediave evropiane e aziatike në destinacionet me elitare të vendit, në krye të listës së të cilave ishte "Prestige Resort". "Me shumë kënaqësi i sollëm të "Prestige Resort" pasi dëshironim të shikonim pjesën e Adriatikut. Për të huajt, kur u përmend Shqipërinë, normalisht që mendojnë plazhet dhe vuna re që këtu ofrohen të gjitha lehtësirat që ata të mund të vijnë me pushime me familjet e tyre. Disa prej tyre do të qëndrojnë edhe më gjatë, pavarësisht se është dita e fundit e çdo eventi lidhur me Asamblesën e Përgjithshme", -u shpreh Duraj.

VLERËSIMET

Ndërkohë, drejtori i marrëdhënieve me jashtë në TV Polak Clayton Reklewski, Louis-Jean vlerësoi organizimin për pritjen e pjesëmarrësve të asamblesë në Shqipëri, duke e cilësuar vizitën e tyre "mbretërore". "Jam shumë i impresionuar. I vlerësoj të gjitha përpjekjet e miqve tanë nga Shqipëria, sepse e di që të organizosh në një mënyrë aq mbretërore vizitën dhe qëndrimin tonë në Shqipëri, kërkon shumë përpjekje sa i përket logjistikës, përgatitjeve. Do më pëlqente të vija sërish këtu. Kam dëgjuar se këtu është mbushur me turistë polakë. Shpresoj që të kem shansin të vij sërish dhe të shijoj diellin, detin etj. Është një vend i mrekullueshëm", -u shpreh Louis-Jean. Më tej edhe drejtori i Bashkimit të Transmetuesve të Azisë dhe Paqësorisit Javad Mottaghi vlerësoi bukurinë e vendit dhe mikpritjen e njerëzve. "Kjo është vizita ime e parë në Shqipëri. Mund t'ju siguroj

"Prestige Resort" hap dyert për drejtorët e mediave ndërkombëtare

Të huajt e impresionuar: Është një pritje mbretërore



Drejtesit e mediave ndërkombëtare në "Prestige Resort"

LOUIS JEAN VIZITË MBRETËRORE

"Jam shumë i impresionuar. I vlerësoj të gjitha përpjekjet e miqve tanë nga Shqipëria, sepse e di që të organizosh në një mënyrë aq mbretërore vizitën dhe qëndrimin tonë në Shqipëri, kërkon shumë përpjekje sa i përket përgatitjeve. Do më pëlqente të vija sërish këtu. Kam dëgjuar se është mbushur me turistë polakë", -u shpreh Louis-Jean.



JAVAD MOTTAGHI VLERËSOJ MIKPRTJEN

"Kjo është vizita ime e parë në Shqipëri. Mund t'ju siguroj se do të vij sërish, sepse vendi juaj është kaq i bukur dhe moti është i mirë, natyra e bukur, uji dhe ushqimi i mirë dhe ajo çfarë ka më shumë rëndësi janë njerëzit. Keni njerëz mikpritës, të sjellshëm dhe ne jemi shumë të lumtur që i takojmë", -tha Mottaghi.



se do të vij sërish, sepse vendi juaj është kaq i bukur dhe moti është i mirë, natyra e bukur, uji dhe ushqimi i mirë dhe ajo çfarë ka më shumë rëndësi janë njerëzit. Keni njerëz mikpritës, të sjellshëm dhe ne jemi shumë të lumtur që i takojmë", -tha Mottaghi. Gjithashtu, drejtoresha e Përgjithshme e Radio Televizionit Kroat Marija Nemčić vërejtë ndryshimet që kanë ndodhur në vendin tonë vitet e fundit. "Jam shumë e befasuar nga përmirësimi që kenë bërë brenda 5-6 viteve. Më pëlqejnë njerëzit në vendin tuaj. Në Shqipëri nga njëra anë ka mundësinë të shohësh vendin dhe ndërtimet, por nga ana tjetër janë edhe njerëzit, të cilët janë aq miqësorë dhe mendoj se kjo është pjesa më e rëndësishme e vizitës sonë dhe e Shqipërisë", -deklaroi Nemčić. "Prestige Resort" po mirëpret me mijëra turistë nga brenda dhe jashtë vendit dhe e gjithë kjo falë pozitës së favorshme, kombinimit ideal të natyrës, shërbimit cilësor nga ana e stafit profesionist dhe komoditetit. Ky resort është kthyer në një nga destinacionet më të rëndësishme e më të frekuentuara në Shqipëri e në rajon.

Vetëm 1.7% arrijnë të marrin dhjetë

Provimet me zgjedhje të Maturës, 6.6% e maturantëve rezultojnë ngelës



gjithë vendi.

Tashmë nxënësit kanë arritur të marrin përgjigjet për të gjitha provimet e zhvilluara për Maturën Shtetërore 2018-të, e në këtë mënyrë mund të bëjnë një përllogaritje të pikëve që kanë arritur të grumbullojnë në total. Ndërkohë,

çdo universitet ka shpallur kriteret e pranimit për programe specifike të studimit. Në faqen zyrtare të çdo universiteti, maturantët mund të informohen mbi mënyrën e përllogaritjes së pikëve për të parë se në cilat degë mund aplikojnë e të shpallen fitues.

6.6%

VLERËSOHEN ME NOTËN 4

Respektivisht, sipas Ministrisë së Arsimit, Sportit e Rinisë 6.6% e maturantëve janë vlerësuar me notë negative, pra 4. "Publikimi i notave të lëndëve me zgjedhje përbyll edhe procesin e Maturës Shtetërore 2018. Faleminderit!", - theksohet në njoftimin e MASR. Çdo universitet ka shpallur kriteret e pranimit për programe specifike të studimit. Në faqen zyrtare të çdo universiteti, maturantët mund të informohen mbi mënyrën e përllogaritjes së pikëve

1.7%

VLERËSOHEN ME NOTËN 10

Ndërkohë vetëm 1.7% e nxënësve kanë arritur të kapin rezultatin maksimal e të vlerësohen me notën 10. Në njoftimin e MASR bëhet me dije se në testimin e lëndëve me zgjedhje kanë marrë pjesë plot 36 328 maturantë nga i gjithë vendi.

Ambasadori amerikan: As Beogradi e as Prishtina s'do marrin atë që duan

Aleksandër Vuçiç: S'jemi në pozitë të lehtë me Kosovën

Vetëvendosje: Kuvendi duhet t'i vërë vijat e kuqe Serbisë

Presidenti i Serbisë Aleksandar Vuçiç zhvilloi një takim me komisarin evropian për Zgjerim Johannes Hahn, i cili gjendet për vizitë zyrtare në Beograd. Vuçiç deklaroi se Serbia nuk është në pozitë të lehtë për Kosovën dhe se të gjithë nuk e duan kompromisin, transmeton Koah.net. "Po ne nuk do të lejojmë që të përulet Serbia", ka thënë Vuçiç duke shtuar se "nuk duam luftë dhe se po qe nevoja do të bisedojmë edhe nga tri herë në ditë me Kosovën". Komisar Hahn ka thënë se të gjithë e dinë se Kosova "është çështje e hapur" porse, siç përcjell "Blic" i Beogradit, ajo nuk është e gjitha dhe çdo gjë që Serbia të përparojë në rrugën europiane". Hahn në Beograd ka shkruar me marrëveshjen që Serbisë ia jep 41 milionë euro ndihmë për anëtarësimin e saj në Bashkimin Evropian. BE ka premtuar edhe ndihma të tjera për Beogradin. Ndërsa ambasadori amerikan në Beograd, Kyle Scott ka deklaruar se dialogu mes Prishtinës dhe Beogradit duhet të hyjë në fazë intensive, me shpresë se kompromisi do të arrihet "me gjasë gjatë këtij viti". Scott ka deklaruar për televizionin serb (RTS) se është e qartë se as Beogradi e as Prishtina nuk do ta marrin atë që e dëshirojnë, por, siç ka thënë ai, është me rëndësi që palët të arrijnë deri te kompromisi, transmeton "Zeri.info". "Për këtë është shumë i rëndësishëm ky dialog që udhëhiqet nga BE-ja. Mendoj se duhet të hyjë në fazë intensive, shpresoj se do të arrihet kompromisi, ka mundësi që edhe gjatë këtij viti", ka thënë mes tjerash Scott, duke shtuar se kompromisi nuk duhet kuptuar si një "fjalë e keqe", por kompromiset janë shtylla të politikës ndërkombëtare. Ndërkohë që Lëvizja Vetëvendosje e kundërshtoi rolin prijës të presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, në dialogun me Serbinë. Gjatë një konference për media, nënkryetari i Vetëvendosjes, Glauk Konjufca, tha se gatishmëria e vazhdueshme e presidentit Thaçi për të qenë në krye të delegacionit të Kosovës në dialogun me Serbinë, mund të jetë një lloj përpjekjeje për të shtyrë për pak muaj, siç tha ai, funksionalizimin dhe funksionimin e Gjykatës Speciale për krime lufte, nga e cila, sipas Konjufcës, presidenti mund të ketë frikë. Ai tha se Thaçi, me insistimin e tij që të jetë në krye të dialogut, e ka uzurpuar procesin. "Presidenti Thaçi ia hoqi vijat e kuqe



Presidenti i Serbisë Aleksandër Vuçiç

KYLE SCOTT:

"Për këtë është shumë i rëndësishëm ky dialog që udhëhiqet nga BE-ja. Dialogu mes Prishtinës dhe Beogradit duhet të hyjë në fazë intensive, me shpresë se kompromisi do të arrihet me gjasë gjatë këtij viti", ka thënë mes tjerash Scott.

Daçiç: SHBA është futur tërthorazi në të gjithë procesin

Dialogu Serbi-Kosovë, ministri i Jashtëm serb: Jo futjes së 'lojtarëve të rinj'



Ivica Daçiç, ministri i Jashtëm serb

Ivica Daçiç, ministri i Jashtëm serb, ka thënë dje se ka pasur kërkesa krejtësisht të paarsyeshme që tani në dialogun mes Beogradit e Prishtinës të futen "lojtarë të rinj". Ai thotë se kjo po bëhet vetëm për të forcuar pozicionin e Prishtinës dhe theksoi se presioni nuk do të përshpejtoje kompromisin. "Shtetet e Bashkuara janë dhe tashmë të

nuk mund të dalë në këtë dialog", tha Konjufca, shkruan rel. Ai tha se vijat e kuqe nënkuptojnë se nuk ka autonomi e as asociacion për serbët e Kosovës,

IVICA DAÇIÇ:

"Ka pasur kërkesa krejtësisht të paarsyeshme që tani në dialogun mes Beogradit e Prishtinës të futen "lojtarë të rinj". Kjo po bëhet vetëm për të forcuar pozicionin e Prishtinës dhe presioni nuk do të përshpejtoje kompromisin.

informuar mirë dhe tërthorazi të futur në të gjithë procesin", i tha ai gazetës "Večernje Novosti", duke komentuar mbi ftesën e kryeministrit të Kosovës Ramush Haradinaj për të angazhuar Shte-

sikurse që nuk duhet të ketë ndarje e as shkëmbim terriroresh me Serbinë. Konjufca tha se presidenti Thaçi po paraqitet si një aventurier politik, andaj,

tet e Bashkuara në dialog. Përveç kësaj, faza e re e dialogut mes Kosovës dhe Serbisë do të ndërmerretë nga drejtoresha për Evropën Perëndimore, Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë, si dhe zëvendësdrojtore menaxhuese në Shërbimin Evropian të Veprimit të Jashtëm, Angelina Einchorst. Misioni i saj është që të përshpejtojë dhe intensifikojë bisedimet ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, duke synuar zbatimin e marrëveshjeve të arritura në Bruksel. Mirëpo, në Serbi po kundërshtohet edhe ajo. Atje kanë frikë se Einchorst do t'i dalë në krah Kosovës në shumë raste, ndaj e kanë kundërshtuar praninë e saj duke e cilësuar si të njëanshme.

sipas tij, partitë politike duhet ta ndalin në mënyrë që Kosova të mos rrezikohet nga veprimet e tij në dialogun me Serbinë.

SHKURT

Dyshonin për terrorizëm, policia belge arreston çiftin

Autoritetet belge thanë se kanë arrestuar një burrë dhe një grua nën dyshimet se kanë planifikuar të sulmojnë një ngjarje të fundjavës, të organizuar nga një grup i opozitës iraniane në Francë. Të dyshuarit u arrestuan të shtunën në rajonin e Brukselit dhe u akuzuan për komplot për të sulmuar një konferencë të organizuar nga organizata Mujahedin-e Khalq, e cila u mbajt pranë Parisit, njoftoi të hënën prokuroria belge. Sipas saj, të dyshuarit, të identifikuar si Amir S. dhe Nasimeh N., të dy shtetas belge, janë në të tridhjetat. Prokurorët thanë se çifti është ndaluar me makinën e tij, ku janë gjetur rreth gjysmë kilogrami eksploziv TATP dhe një tjetër lëndë plasëse. Pas arrestimeve, policia bastisi edhe pesë shtëpi, por nuk dha detaje të tjera. Organizata Mujahedin-e Khalq mbështet rrezimin e udhëheqjes së Iranit.

Turqi, urdhërohet arrestimi i

dhjetëra kolonelëve

Turqia ka urdhëruar ndalimin e 68 të dyshuarve, duke përfshirë dhjetëra kolonelë, në një operacion që ka shënjestruar mbështetësit e supozuar të klerikut fetar, Fethullah Gulen, të cilin Ankaraja e akuzon për orkestrim të tentimeve të dështuara për puç dy vjet më parë, ka njoftuar agjencia shtetërore turke, Anadolu. Nëntëmbëdhjetë zyrtarë në detyrë janë në mesin e personave që do të përballen me ndalim, në operacionin e zgjeruar në 19 provinca, duke përfshirë kryeqytetin turk, Ankarën. Agjencia ka cituar disa burime nga Zyra e kryeprokurorit se është gjetur që të dyshuarit kanë qenë në kontakt me Gulenin. Turqia ka ndaluar 160,000 persona dhe ka shkarkuar gati numrin e njëjtë të zyrtarëve nga pozitat e tyre pas tentimeve të dështuara për grusht shteti, ka njoftuar në mars, Zyra për të Drejtat e Njeriut në Kombet e Bashkuara. Në mesin e tyre, më shumë se 50,000 persona janë akuzuar dhe janë mbajtur në burg në kohën e gjykitimit. Kritikët e presidentit turk, Recep Tayyip Erdogan akuzojnë atë për përdorim të puçit të dështuar si arsyetim për të shtypur kundërshtarët. Turqia në anën tjetër deklaroi se masat janë të nevojshme për të luftuar kërcënimet ndaj sigurisë kombëtare.

DEBATI PER TEATRIN

Aktorët 'bojkotojnë' përrurimin e TURBINËS, Kumbaro: Mendoj si shoqëria civile...

Rama: Basti me teatrin i humbur, aktorët s'kanë punë me muret

Kryeministri: Ndrenika i fundit i mohikanëve, kush vjen pas tij

Edmond Tupja kundër shembjes: Kryeministri ndoshta nuk vlen as sa kryekomunari i fshatit...

Fatmira Nikolli

Tingujt e La Boheme tërhiqnin kalimtarët dhe në orën 20:30 në skenën e retë të artit Turbina, pranë Liqenit. Oborri që plot me artistë të Operës e Baletit (që edhe performuan) me në krye drejtoreshën dhe ata të Metropolit me në krye drejtoreshën. Krahas tyre nuk mungonin as punonjësit të Ministrisë së Kulturës ndërsa aktorë, qenë veçse një grusht nga Artan Imami, të Ben Kumbaro, nga Gent Deçka të Kastriot Çaushi, nuk shihje më shumë se 15 njerëz të skenës bashkë me drejtorë teatros. Fjalën e hapjes e mbajti Mirela Kumbaro duke e nisur rrëfimin e saj të një telefonate me Hervin Çulin më 2014. "Ishte i murrar kur më tha se prapaska e skenës së TK po binte. Nuk i lamë më aktorët në atë zonë. Kërkuam e zbuluam këtë pronë publike. Nuk qe e lehtë vendimmarrja: të merreshim me Teatrin e Korçës, Shkodrës, me Operën a të gjenim hapësira të reja", tha ajo. U ndal pak kur tha se kemi ende punë duke përmendur GK, BK, TK, MHK. "Na kërkohet t'i bëjmë të gjitha. Do bëhet rikonceptimi i GK e MHK (për të cilin është hapur konkursi). Jo më larg e rëndësishme se sa më lart që edhe një ndalje e saj të raportit që ka me të shkuarën si pjesë e shoqërisë civile. "Gjatë ditëve të nxehta të debatit për TK e kam pyetur veten në cilën anë do isha nëse nuk do isha në këtë detyrë që kam. Do isha me ata që protestojnë për kushte të më mirë e institucione dinjitoze. Jam në anën e shoqërisë civile për institucione më të mira. Por, në rolin e vendimmarrësit duhet të peshosh do zgjidhje në kushtet e një vendi jo të kamur. Një hapësirë me dy skena është model për rikonceptimin e hapësirave të lëna në harresë", tha ajo duke përsëritur më tej çështje të më herët për teatrin e ri kombëtar. Pas saj, fjalën e mori shefi i qeverisë Edi Rama.

Kryeministri përmbodhi sukseset e investimeve në kulturë duke iu përgjigjur atyre që i quajti "gojë të ndyra" e gjithë akuzave. Rama tha se kur erdhi ai në pushtet sallat e shfaqjeve u ngjanin varrezave dhe aktivitetet kulturore u ngjanin përshtirjeve. "Mos kujtoni se do flas për suksese a se mbaroi rrënimin. Por, që gjëra që



pa ne nuk do ishin bërë, ka që çke me të. Rëndësishme e një teatri nuk e bëjmë muret e lagështira. Pyetja nuk është a duhet të ruhet godina, a duhet ngritur një teatër i ri - nuk ka sens të jetë ky shqetësimi i aktorëve që kanë të drejtën legjitime të kërkojnë të drejtën. Teatri Kombëtar nuk është pronë private e artistëve të momentit. Është hapësirë për publikun. Debatit me aktorët e regjisorët për si të jetë më e mirë godina është i domosdoshëm, por jo a duhet a nuk duhet ndërtaur", tha ai. Për kryeministrin që ndonjëherë përsëriti paragrafë e argumentet (e veta e të mazhorancës) muret janë debat arkitektësh. "Historia është shkruar në godina që i kanë lënë vendin njëra-tjetrës. Mbreti Zog e kishte në planet e tij ta bënte të vëllezërit Frashëri para piramidës një teatër, por nuk arriti. Sot bëhet e gjithë zhurma që përbën momentin kulmor e estradës së politikës. Shqipëria ka mbetur i vetmi vend në Europë e rajon pa një skenë të denjë. Pyetja nuk është a duhet ruajtur ajo godinë", tha ai duke përsëritur veten. Mandej ai u rrek t'i jepte një kah tjetër debatit duke e kaluar atë të cilësia artistike. "Kur e shoh sot Robert Ndrenikën në tavolina për teatrin më dhemb shumë e shoh si të fundit të mohikanëve ndërkohë që nuk shoh pasardhësin e tij. Ky është debati. Jo ai i godinës se godina e ka humbur bastin. Nëse ka diç-

ka në përplasjen absurde të këtyre ditëve është shfrytëzimi i hapësirës mes artistëve e qeverisë jo për t'u marrë me muret po me cilësinë. Duhet një teatër të ri se po të kishte gojë ky i vetri do thoshte më liri të vdes. Teatri është për publikun e jo për t'u mbyllur brenda e për të bërë harakiri ata që duan t'i zërë brenda", tha Rama herë duke iu përgjigjur atyre që protestojnë e herë duke u rrekur të intimidojë mendimet kundra. "Singerisht më rezulton e pamundur t'i kuptoj sot që të gjithë kanë parë botë me sy. Kam dëgjuar të thonë që bëni teatër të ri e na liri këtë. As Londra e as Nju York s'janë aq të pasur. As mundemi e as nuk do ta bëjmë kur e kemi mundësinë në zemër të Tiranës. Në rastit të Stadiumit, Teatrit e Bibliotekës Kombëtare që sapo kaloi një situatë të rëndë është para e hedhur dëm". Në këtë pikë, fati i vetë Bibliotekës duket se do të ketë ndryshime...

PROTESTA

Para se të niste përrurimi i TURBINËS, në sheshin para dy teatrove kombëtarë, pa La Boheme, por me pezmin e një marshi funebër, mbahej si çdo mbremje në orën 19:00 protesta për mbrojtjen e godinës e truallit. Mes protestuesve të përnatshëm, për herë të parë ishte edhe përkthyesi dhe shkrimtari Edmond Tupja që e kish refuzuar praninë të TURBIBA. Gjatë fjalës së tij, Tupja solli rastin e një fshati



francez që ruan me fanatizëm një gur ku shekuj më parë ishte ndalur dhe shplohur një mbret i Francës. Shkrimtari solli këtë rast për të bërë krahasimin me vlerat e mëdha që ka godina e teatrit, të cilën kryeministri Edi Rama do përpigjet ta shembë me anë të një ligji që pritet të kalojë këtë të enjte në Kuvend. Duke i kujtuar Ramës që nuk vlen as sa kryeplaku i fshatit francez, Tupja ka bërë thirrje për mbrojtjen e godinës për shkak se ruan dëshmi të shpirtit të aktorëve dhe regjisorëve që kanë punuar aty prej vitesh. "Në një fshat të vogël me më pak se 100 banorë, ishte një gur, tip shkëmbi, që ata e kishin pastruar dhe kishin vendosur një pllakë ku thuhej se filan mbret, këtu, përpara kaq shekujsh, ka ndaluar dhe është shplohur. E ruani, një gur i thjeshtë. Nuk ishte vepër historike, nuk ishte vepër artistike, ishte një copë gur, por një gur që dëshmonte për diçka në kohë dhe atë gur nuk e luante njeri, atë kishin krenari. Ky fshat i vogël që jemi në në krahasim me rruzullin, me një kryeministër që ndoshta nuk vlen as sa kryekomunari i fshatit francez... Ky fshat i vogël nuk nderoi veten, nderoi Francën, nderoi kulturën, historinë... ky teatër, ky objekt, kjo gjë, po e thjeshtoj fjalorin, çfarë ka? Kjo ka historinë. Ka një dëshmi dhe kjo dëshmi për mua nuk lidhet vetëm me një gur ku pi një mbret, ky (teatri) ka dëshmi historike, sepse nuk

është vetëm peizazhi, por shpirti njerëzor", u shpreh ndër të tjera Edmond Tupja. **"TEATRI", PËRPLASJE NË KOMISION** Ministria e Kulturës është paraqitur dhe në mbledhjen e Komisionit të Medias dhe atij të Ligjeve ku do të diskutohet projektligji për Teatrin e Ri Kombëtar. Nuk kanë munguar replikat me Vokshin në Komisionin e Medias. Ndërsa kryetarja e komisionit, Albana Vokshi, i tha se "Po vidhni pronën, po i kërkoj ta tërheqim këtë projektligj", Kumbaro kërkoi të mos ndërpritej. "Zonja ministre po iu bëj thirrje tërhiqni projektligjin, për hir të asaj karrigeje. Jeni akoma në kohë për të shpëtuat dinjitetin tuaj. Mos bëni kryesekretaren e kryehajdutit. Tërhiquni! Po vjedh pronën publike në mes të Tiranës. A do të tërhiqeni nga projektligji?", tha Vokshi. Në përgjigje, ministrja Kumbaro tha se "do të përgjigjem kur të më pyesni për temën e ditës. Më jep fjalën dhe mos më ndërpre". Më tej, Mirela Kumbaro pati mundësinë të paraqiste qetësisht para komisionit arsyet pse duhet një teatër i ri. "Ky objekt nuk u konsiderua i denjë për t'u përfshirë në statusin monument kulture, ndryshe nga objektet të tjera rreth tij, si ndërtesa e Galerisë Kombëtare apo ministritë. Godina e Teatrit Kombëtar,

referuar vlerësimin të ekspertëve, jo vetëm që nuk plotëson asnjë standard bashkëkohor, lidhur me anën funksionale, por, edhe nëse do të kryhej rikonstrukcioni i saj, sado i kushtueshëm dhe i thellë të jetë, nuk e sjell atë në kushtet optimale teknike", tha ajo.

Sipas opozitës, projektligji është në shkelje të Kushtetutës dhe disa ligjeve të vendit. Demokratët akuzuan mazhorancën se po mundohet të shpërndajë përgjegjësinë ligjore duke firmosur të gjitha shkresat e kësaj çështjeje nga zvendëndësit. Jorida Tabaku u pyeti "pse ka qenë zonja ministre e vetmja që ka marrë përsipër ta firmosë, ndërkohë që për Ministrinë e Financave ka firmosur zvendësmministri? Për Kryeministrinë ka firmosur zvendëskryeministri; asnjë dokument nuk ka firmosur kryetari i Bashkisë Tiranë. Pse kanë frikë që ta mbajnë vetë përgjegjësinë?"

THIRRJA PËR PROTESTË

Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit bëri me dije dje se "Parlamenti ka futur për votim në seancën e të enjtes me procedure të përsheptuara projektligjin më të turpshëm në historinë e parlamentarizmit. Ky projektligj parashikon shembjen e Teatrit Kombëtar i cili është pjesë e ansambilit historik monumental të qendrës së Tiranës dhe simbol i identitetit kombëtar, si edhe kalimin e mbi 8000 m2 truall publik në pronësi të firmës Fusha shpk, e cila autorizohet të ndërtojë aty kulla shumëkatëshe". Aleanca shënon se ky projektligj është në kundërshtim me Kushtetutën dhe një seri ligjesh të tjera të Shqipërisë. Artistë, aktivistë, intelektualë e qytetarë kanë muaj që protestojnë kundër kësaj marrëzjeje, e cila, nëse kthehet në realitet, rrezikon të zhdukë përgjithmonë një nga godinat më të vjetra dhe më domethënëse në Tiranë si edhe t'i falë truallin publik më të vlefshëm një kompanie private. Për ta, kjo është vjedhje shkatërrim. Aleanca parlamentare se ditën e enjte, do të jenë përballë parlamentit për të kundërshtuar me forcë marrëzinë dhe babëzinë. "Mund t'i ndalim nëse edhe ti bashkohesh! Të presim të enjten ora 10:00 para parlamentit!"



Debatet në hotel ‘Kolombo’ dhe vrasja në ‘Murat Çelebi’

Hysni Toska, pse ballistët dhe komunistët e vranë deputetin Hysni Toska

Nga Ylli Polovina

Në shkrimin e djeshëm, nisëm të hedhim dritë për të gjitha fjetet e fshehta të një krimi të shëmtuar, vrasjen e një deputeti të Mallakastrës, Hysni Toskës, si edhe të djalit të tij të vetëm, Skënderit. Në të vërtetë, ai krim, nëpërmjet vrasjesh të tjera, shkoi zinxhir i pandalur për tërë një gjysmë shekulli. Të gjitha gjurmët kryesore të kësaj llahtarë të çojnë mbi të gjitha tek njerëz të Lëvizjes Nacionalçlirimtare dhe të PKSH-së, por ky Enver Hoxha apo Mehmet Shehu, ky i fundit vendas nga Mallakastra, nuk kanë qenë ndërthënë. Ata gjithsesi e dinin. Këtu edhe për ta nis përgjegjësia, por, le ta vijojmë rrëfimin e rrjedhës së pabesë së kryer në shtator 1943 në lagjen ‘Murat Çelebi’ të qytetit të Beratit, gjithnjë mbështetur mbi librin e botuar rish-tazi, të tejmbushur me informacion, dokumente të shkrjuara dhe dëshmi të folura, i Nuri Plakut. Kur Hysni Toska, deputet në tri legjis-latura gjatë periudhës së Zogut, pa se njeriu që kish mbështetur për të mirë të Shqipërisë në 7 prill 1939 u largua pa qëndresë, pasi vetë me vullnetarë e tij luftoi agresorët në Bestrovë të Vlorës dhe u tërhoq në Berat për të vazhduar atje me armë rezistencën, duke i thënë faqezi theu bustin e Mbretit ikës. Qau ndërsa pa që atdheu i tij u pushtua. Ish-partizani Llazar Bane, vë në dukje çfarë i ka thënë një bash-këqytetës: ‘Kur Hysni u kthev nga Italia ku qe burgosur pas pushtimit të vendit, unë i va-ja një në shtëpi. Në mes të tjerash i them se ç’dó të bëhet me Isa Toskën që po bën shumë krime në popull. Ai m’u përgjigj se Isai duhej vrasë, por s’kishte kush ta vraste.’

ISA TOSKA, GJENERALI FALS I ITALIANËVE

Sipas librit të Nuri Plakut, Isa Toska ‘e kish-te filluar veprimtarinë e tij kriminale në vitin 1937 me vjedhjet e ndryshme në pronat e bash-këfshatave të vet. Një vit më vonë u arrestua dhe u burgos prej forcave të rendit. Me pushtimin e vendit doli sërisht nga burgu. Nga fundi i vitit 1940 formoi një çetë me elementë të diskredituar dhe filloi të grabiste e të bënte terror në gjithë zonën e Roskovecit dhe Mal-lakastrës. Për të gjitha ekzekutimet ishte cak-tuar një vend në kufirin Luar-Kuqan, që nda-heshin nga Përroi i Siqecës, i quajtur gropa e Haraçit...’ Në vijim: ‘Partia Komuniste u për-poq të tërhiqte...në Frontin Nacionalçlirimtar’ dhe se dështuan. ‘Pikërisht në këtë periudhë, nënvezin Plaku, fashistët i dhanë atij gradën e gjeneralit, e cila ishte një mashtrim për ta joshur e përdorur kriminelin në punët e pisa-ta’. Kjo çudi ngjau në 26 nëntor 1942. Sipas tekstit shpallës mareshal Maxhiore Martini Antonio, Komandant i Stacionit Karabinieri-së Mbretërore Berat, e njoftonte Isa Toskën se, sipas propozimit të kësaj komande, me urdhër të N.M. tij, Viktor Emanuelit III, ishte falur dhe emëruar me gradën ‘Gjeneral’, që të punonte me fuqitë civile për të ruajtur si zonën e Luar-it, ashtu dhe gjithë prefekturën e Beratit, ‘për të mos u shkëlur, grabitur e plaçkitur nga disa të poshtër dhe të ashtuquajtur komunista. Me vullnetin tuej si një fashist i përsosur, - thuhet në dokument, - ne do ja arrijmë qëllimit tue-i çduk këta elementa rusë nga gjithë rrethi i Prefekturës t’onë, sidomos nga nënprefektura e Skraparit’. Loja e italianëve dhe hileja politike e Isa Toskës ishte: çeta e tij të quhej nacionaliste, pra balliste. Roli i tij, sipas nesh, ndër-sa në libër thuhet se startoi për veprim në janar 1943, që në thelb diversion për të nxiturr vël-lavrasjen mes shqiptarëve, pasues të PKSH-së apo të BK të ish-in. Kjo intrigë, këmbëngulim, përkon me nismën e dy palëve, pasuesve komunistë dhe atyre të Ballit, për mbarëvajtjen e pranverës së bashkëpunimit të tyre që zgjati pak a shumë mbarë deri në përfundimin e Mar-



Në foto: HYSNI TOSKA ME DY ROJET

rëveshjes së Mukjes. Këto rrethana rreziksh-mërie të lartë, mendojmë, Hysni Toska i ka di-tur, siç edhe partizanët sigurisht. Sipas Nuri Plakut dhe librit të tij mjaft të veçantë, ‘...Hys-ni Toska, më 12 mars të vitit 1943, organizoi eliminimin e kriminelit, nëpërmjet Tafil Pa-jës, bashkëfshatarit të tij i cili sapo kishte dalë nga burgu fashist së bashku me të birin, Skën-derin. Tafil ishte djali i Islam Pajës, bujk i Hys-niut, i cili jetonte në Luar në një shtëpi të dhur-ruar nga Hysni. Këtë të dhënë e gjejmë në ditarin e Kristaq Tutulanit, mbajtur vetëm për 6-mujorin e parë të vitit 1943.’ Përkërisht në një nga faqet e këtij ditari, atë të datës 21 shkurt 1943, thuhet konkretisht se: ‘Isa Toska ble armë me të holla për italianët në Doshnicë. Një naionalist lidhur me Hysniën gati të ndër-hyjë për të vrarë Isanë. Është i vetmi i besuar tek Hysni.’ Referuar librit të Nuri Plakut, ‘Më 23 mars 1943, njëmbëdhjetë ditë mba-atentatit të organizuar nga Hysni Toska, Isa Toskës iu bë një pritje e organizuar nga çeta e Jagodinës dhe një pjesë e partizanëve të Skra-



Në foto: Skënder Toska partizan në Berat

parit, që ndihmonin gjallërimin e lëvizjes çli-rimtare në Myzeqe. Midis tyre ishin edhe Zylyf-tar Veleshnja, Tofik Lapani, Xhevahir Spatha-rra etj. Prita u bë në kufirin ndërës të fshatra Marimëz e Belinë, të cilët i përshkonte një kënetë e midistë dhe pikërisht në pjesën e quaj-tur ‘Vau i Rosave’. Por nga kjo pritje Isai nuk u asgjësua. Nga radhët partizane mbeti i vrarë djaloshi nga Skrapari Tofik Lapani, ndër-sa nga banda kriminale u vranë 4 vetë.’

Për këtë episod autori i këtij shkrimi ruan në arkivin e tij edhe një bisedë, të bërë në vitin 1976, me ish-partizanin e njohur beratase Ura-ni Kudra. Sipas saj, njësi të Zylyftar Veleshnjës e kishte pritur në pusi Isa Toskën dhe bandën e tij për plot dy javë dhe se ai pati shpëtuar për shkak ‘të rolit të dy anëtarëve të qarkorit me origjinë klasore të pasur që bënë lojën e agen-tit. Ata u dënuan më vonë’.

Vazhdon Nuri Plaku në librin e tij: ‘Sipas kujtimeve të së bijës së Hysniut, Ervehesë, e cila ka qenë dëshmitare okulare pranë të atit, Hysni Toska e ndiqte luftën në Vau e Rosave me dylbi nga papafingoja e shtëpisë së tij në Luar. Sipas saj, ai ishte në djepin e plotë për rrethimin dhe luftën që do t’i bëhej Isait në Marinëz. ‘Unë, - kujton ajo, - kam qenë në pa-pafingo, kur ai ndiqte luftën me dylbi dhe fliste me vete duke thënë: ‘e rrethuan qenin’. Pas pak dëgjoj shprehjen: ‘shpëtoi qeni!’ Mb-s kësaj prite, kur u pa që kriminelin nuk u asgje-sua, babai shaloi kalin dhe u nis menjëherë për në Berat...’ Më tej: ‘Në Berat ai u vendos filli-misht në shtëpinë e dhëndrit të tij, Selman Pobratis deri sa gjeti një banesë dykatëshe, në lagjen ‘Murat Çelebi’, të cilën e mori me qira’. Dy muaj më pas, në fundmaj, Isa Toska me ndjekësit e vet u shfaq në qytetin ku ishte strehuar Hysni. Rrëfen e bija: ‘Ai kaloi vetëm një herë para shtëpisë tonë, me autobлиндë dhe ushtarë, duke parë me egërsi nga dritaret tona, qëndroi një moment dhe iku. Babai dhe kom-plet familja ishim bërë gati për luftë po të sulmonte.’

Në mesditën e datës 13 shtator, në Fier er-dhi kolona ushtarake italiane e Kumanit, e cila do të shkonte në Vlorë. Së bashku me ta ishte edhe kriminelin Isa Toska me të vëllanë Fasli-ud dhe 50 bashibozukët e tij, të veshur me uni-formën ushtarake italiane të Divizionit ‘Bren-ero’. Në orën 15:00 Komandanti i Rrethit, Kapiten Hilmi Beluli dhe oficerët Abas Sevrana

ni e Rusht Çarçani, takuan nënprefektin Zef Pepa dhe i thanë të vinin në Komandën Gjer-manë për të kërkuar dorëzimin e kriminelit Isa Toska dhe vëllait të tij në xhandarmëri, pasi për arrestimin e tyre kishte një urdhër të përherëshëm. Më pas, thirrën edhe Kryetarin e bashkisë, Arshi Shehuni me përkthyesin Abe-din Hoxha dhe së bashku shkuan në komandën gjermane. Komandanti gjerman e mirëpriti kërkesën e tyre dhe thirri menjëherë një skuadër me tre ushtarë. Nga xhandarmëria kërko-i t’i shoqëronte dikush sa për t’u treguar ushtarëve se kush ishin vëllezërit Toska. Për-faqësuesit e qytetit i shpjeguan komandantit se dy të kërkuarit ishin persona të armatosur dhe shumë të rrezikshëm. Por komandanti gjer-man nuk i dha rëndësi këtij fakti, buzëqeshi dhe kërko-i vetëm t’i tregojë se kush ishin. Kapiten Hilmi u urdhëroi aspirant Rushtit Çarçanin të organizonin pritë të xhandarmëri-së nga të gjitha anët e mundshme, nga mund të ishte kriminelin në rast se shpëtonte. Abas Sevran, së bashku me Komandantin e Postës së Qendrës, kapter Selami Barutin e rrehtarë Qemal Hapshin, shoqëruan tre ushtar-ët gjermanë të grumbullimi ku ishte Isa Toska me të vëllanë, ndër-sa Komandanti i Rrethit Hilmi Beluli, nënprefekti Zef Pepaj, sekretari Zybi Coxhaj, Kryetari i bashkisë Arshi Shehu, përkthyesi Abedin Hoxha së bashku me të vël-lanë togerin Fiqiret Hoxha, u drejtuan për në komandën e rrethit. Por, para se të arrinin atje, filluan gjuajtjet me armë. Sipas informatave, Isa Toska, sapo pa aspirant Abas Sevranin, së bashku me dy shokët dhe tre ushtarët gjermanë, e kuptoi se çfarë e priste dhe, pasi iu drejtua Abasit me cinizëm e fyerje, zbrazi armën kundër tij. Abas Sevran iu përgjigj flakë për flakë me revolver dhe gjuajti vetëm një herë kundër tij, duke i hapur një plagë në gjoks. Në moment, Isa Toska u largua ‘me shpejtësinë e zotësinë e një tigri’, në drejtim të ka-zemrës së xhandarmërisë, ku u prit me plumb-at e xhandarëve dhe mbeti i shtrirë për tëk- t’i larë në gjak pikërisht para portës së saj. Ushtar-ët gjermanë së bashku me xhandarët sh-trinë të vdekur për tokë rreth 16 shokë të Isait, kurse i vëllai iku përmes plumbave në drejtim të Gjanicës dhe mundi të shpëtonte’.

VRASJE NJË PAS NJË

Deputeti Hysni Toska do të vritej dy ditë më vonë, në 15 shtator 1943. Nuri Plaku në librin e tij shkruan se Hysni: ‘Në paraditen e datës 15 shtator, e thirrën për një takim konsultativ në hotel ‘Kolombo’. Në takim ishin përfaqësuesit e forcave partizane të qarkut: Zylyftar Veleshnja, Sadik Mbolani, Neshat Hysi e Gjin Marku. Ndërsa nga forcat e Ballit Kombëtar mer-te pjesë Kadri Cakrani me të tjerë’.

‘T’i fiksojmë një cast këta emra! Janë ekspo-nentët më të lartë të lokalë të Lëvizjes Nacio-nalçlirimtare (PKSH) dhe të Ballit Kombëtar. Ato kohë Beratit përjetonte kompromisin e trefisht: partizanë, ballistë, gjermanë. Vijn studi-uesi Plaku: ‘Sipas autorit të librit ‘Toskët e Luarit të Mallakastrës’, Sh.A. Toska, të dhënat konkrete mbi këtë takim, janë nxjerrë nga dëshmia gojore e nipit të tyre, partizantit Asqeri Hoxha, i cili atë ditë, bënte shërbimin e rojes të dera e dhomës ku zhvillohej takimi. Sipas këtij dëshmitari, flumurin e llogaris kundër Hysni Toskës e mbante ngritur Kadri Cakrani, zëri i të cilit dëgohej deri jashtë’. Nuri Plaku e paraqet në libër gjithë bisedën e kryer, me akuzën përse Hysni nuk e kish vrarë më parë se kjo të ndodhte, Isa Toskën. Autori ndërko-hë ka rreftyer edhe bashkëpunimin, por njëherësh edhe kundërshtimet e forta, që kishin pasur më parë, në pasparësitë, Hysni Toska me xha-hanë e Kadriut, Bektash Cakranin.

Referuar Ervehesë, dëshmitare e rëndë-sishme e kësaj pabesie, kur i ati doli nga hotel ‘Kolombo’ dhe hipi në një pajton nga ata që prej qendrës së qytetit të çonin në lagjen ‘Murat Çelebi’, drejt tij u hodh



Dje në "Deutsche Welle"

Politikë në stilin e vetëshkatërrimit

Nga Felix Steiner

(vijon nga faqja 1)

... pune që keni për detyrë të bëni!" të vjen të thërrasësh në drejtim të Zyrës Kancelarore dhe të zyrave qendrore të partive, siç e bëjmë këtë çdo mëngjes ne, tak-sapaguesit e kësaj republike. E bëjmë këtë edhe me kolegë që nuk i durojmë dot ose nën eprorë, vendimet e të cilëve nuk i quajmë vetëm të mençura.

DËSHIRA KONTRADIKTORE TË QYTETARËVE

Le ta pranojmë - as ne qytetarët nuk ia bëjmë të lehtë politikës për momentin. Sepse siç dëshmojnë të gjitha sondazhet, propozimet e shefit të CSU-së Horst Seehofer gjëjnë një mbështetje të gjerë në popull. Dhe janë pikërisht këto sondazhe që u dhanë zemër kristiansocialëve rebelë nga Bavaria. Nga ana tjetër, që kjo politikë mund të realizohet vetëm me çmimin e një krize të fortë qeveritare dhe me dështimin e koalicionit, këtë ne nuk e duam po ashtu me shumicë - dhe aq më pak e duan zgjedhësit e partive unioniste që e duan rregullin edhe si parim. Sepse, pyetja që shtrihet është: çfarë ka ndryshuar sot nga situata e tri muajve më parë, kur u krijua kjo qeveri e përbërë nga CDU, CSU dhe SPD pas përpjekjeve shumë të vështira? Dhe



qytetari pyet më tej: në ç'masë mund të quhet ende ky konflikt, konflikt për çështje përmbytësore politike? A nuk ka prej kohësh ai karakterin e një dyluftimi midis Seehoferit dhe kancelares gjermane thjesht për motive njerë-

zore? "Me këtë grua unë nuk mund të punoj më" - po ta ketë shqiptuar vërtet kështu këtë citat - të cilin ndërkohë Horst Seehoferi e mohon - atëherë që atëherë ai e ka hedhur dëm prestigjin e tij. Sjellja profesionale ka pamje tjetër.

Por e vërtetë është që edhe Angela Merkel po bën gabime dramatike këto ditë. Po, në takimin e nivelit të lartë të BE ajo arriti në negociata suksese, të cilat nuk e kishte besuar askush se do t'i arrinte. Por të krijon çdo gjë tjetër,

por jo besim, kur Zyra Kancelarore bën të ditur se me cilët partnerë ka arritur marrëveshje, dhe tri shtete e kundërshtojnë këtë pak më vonë në mënyrën më të ashpër. Kujt t'i besosh tani? Dhe besimi - këtë e di çdo kryetar bashkie fshati - është monedha e mirëfilltë e këmbimit. Ai të cilit nuk i besojnë, ai ka marrë fund politikisht.

NUK KEMI KRIZË SH-TETËRORE

Kjo krizë nuk është krizë sh-tetërore. Sepse edhe sikur CSU-ja të largohej nga qeveria, të Gjellbrit janë afuar të gatshëm për t'u bërë partnerë të rinj të koalicionit. Prandaj edhe zgjedhjet e reja - pavarësisht si do të përfundojë dita e sotme - janë me shumë pak gjasa. Kjo është në radhë të parë krizë e partive unioniste, të cilat gjithmonë kanë deklaruar kaq të sigurt se pa to nuk mund të krijohet qeveri.

"Hidheni vështrimin një herë përtej Alpeve", të vjen t'u thërrasësh CDU dhe CSU-së. Në Itali demokristianët, pa të cilët prej dekadash ishte e pamundur ta përfytyroje sistemin politik, u shkatërruan krejtësisht me vullnetin e tyre. Dhe pastaj thjesht u shpërbënë, pa u shqetësuar kush nga kjo. Po sot, kush e drejton Italinë? E pra. Ndoshta populistët e djathtë të AfD-së kanë nisur prej ditësh të hapin shishet e shampanjës.

BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.
LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.

MERRNI NE KOHE REALE
LAJMET E FUNDIT NE
APARATIN TUAJ



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET

KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID

BalkanWeb.com
BW

FALAS



Opinion *i* Ditës

Teatri si monumenti i fundit i qytetit dhe lirive tona

Nga Andi Bushati

(vijon nga faqja 1)

... më të rëndësishme që po zhvillohen për të ardhmen. Ajo nuk mund të shihet vetëm si një çështje aktorësh lapangjozë që shiten dhe blihen.

Ajo nuk mund të paraqitet vetëm si një debat mes atyre që duan të renë apo të vjetrën.

Ajo nuk mund të ketë vetëm dimensionin e një ndeshjeje mes mbrojtësve fanatikë të trashëgimisë dhe kundërshtarëve të tyre.

Ajo nuk mund të pasqyrohet vetëm si pezëm i nostalgjikëve që duan të përjetësojnë nostalgjinë për Naim Frashërin, Sandër Prosin, Violeta Manushin dhe së fundi Bujar Lakon.

Pro apo kundër saj, nuk mund të jesh vetëm nëse admiron aftësinë prej sekseri të paskrupullit të Veliajt, as se mbështet delirin e ndërthurur me grykësi të Edi Ramës, as se nuk honeps dot Lulin apo Saliun e 21 janarit, apo se s'ke shpresë tek blloku i Ilirit apo Monikës.

Përtej këtyre ndasive apo bindjeve, qëndron historia e një grabitjeje të madhe. Pas tyre qëndron vjedhja e afro 200 milionë eurove nga një kompanie private, kliente e kryeministrit, me anë të një ligji antikushtetues të parlamentit. Pas saj qëndron vjedhja, ditën për diell, e një trualli publik, pa garë dhe pa tender dhe ngritja e një mostre pa konkurrencë dhe pa konkurs ndërkombëtar.

Kushdo që do ta dëgjonte këtë argument, mund të ngrinte supet i çuditur: e pse duhet të na revoltoka një vjedhje më shumë? A nuk ka ndodhur e njëjta histori në rrugën e kombit, në Gërdec, në privatizimin e ARMO-s dhe të CEZ?

A nuk ka ndodhur kështu me inceneratorët, me lojërat e fatit, me Check up-in, me sa e sa koncesione dhe PPP skandaloze?

Edhe ky cinizëm ekstrem, sado i përligjur të duket për mëkatet që konsumohen përpara syve tanë, nuk është i mjaftë për të justifikuar indiferencën në betejën për teatrin.

Sepse, sado i rrëqethshëm të duket krimi ekonomik-kulturor i shembjes së tij, ai është edhe më shumë sesa kaq.

Sepse godina e dikurshme e rrethit italo-shqiptar "Skanderbeg", është barrkada e fundit për të ndaluar shkatërrimin përfundimtar të kryeqytetit.

Nëse Teatri shembet, pas tij do të bien njëri pas tjetrit sheshi Nënë Tereza, që do të mbushet me dyqane dhe kulla të larta përkrah universitetit, hapësira e gjelbër mbrapa ish-Sheratonit dhe pylli që ka pas, diga e liqenit që do të jetë e pafuqishme të mbajë presionin e grataçelave e



në fund, edhe hapësira përreth sheshit "Skënderbej", që është konceptuar që tani si shfyrje për rrokaqiejt e oligarkëve.

Ky skenar ourellian nuk do të përfundojë vetëm me vdekjen

e Tiranës së jetueshme. Ai do të sanksionojë njëkohësisht fundin e zbatimit të ligjit prej pushteteve në këtë vend, ai do të farkëtojë një aleancë kriminale mes kryeministrit dhe biznesmenëve

që janë të gatshëm të bëjnë çmenduri nën mbrojtjen e tij, ai do të kalçiflojë në një të vetme (ash-tu siç janë të gjitha lidhjet e ngjizura në krim) pushtetin e parasë dhe atë të politikës.

Shembja e atij monumenti, për të cilin kanë 20 vjet që i parathohet rrënimin, që e kanë shpallur vdekjeprurës dhe kanceroz, përtej çdo ndasie, është një test për shoqërinë tonë. Nëse ai bie, gjithçka nga kryeqyteti i vjetër që konceptuan italianët do të zhbëhet me shpejtësi, por më shumë sesa godinat do të rrezohet njëra pas tjetres edhe garancitë që na mbrojnë nga lidhja fashistoide me biznesit dhe politikës.

Përtej këtyre ndasive apo bindjeve, qëndron historia e një grabitjeje të madhe. Pas tyre qëndron vjedhja e afro 200 milionë eurove nga një kompanie private, kliente e kryeministrit, me anë të një ligji antikushtetues të parlamentit. Pas saj qëndron vjedhja, ditën për diell, e një trualli publik, pa garë dhe pa tender dhe ngritja e një mostre pa konkurrencë dhe pa konkurs ndërkombëtar.

HOROSKOPI

DASHI

Nëse në të kaluarën jeni tërhequr për të qenë vetëm, tashmë keni dëshirë të zbatimit në grup, duke pranuar çfarëdolloj ndryshimi. Ndryshojni pikëpamjet tuaja për t'ju përshatur atyre të partnerit tuaj, nëse nuk janë të njëjta.

DEMI

Keni dëshirë të vendosni një mirëkuptim edhe më të thellë me personin e zemrës, që do t'ju kuptojë menjëherë dhe do t'ju dëgjojë. Keni përkrah një partner vërtet të veçantë! Do të zmadhoni rrethin e të njohurve dhe do të krijoni kontakte të shumta me njerëz të ditur.

BINJAKET

Mund të keni ndonjë dhembë dashurie. Ndoshta duhet të pyesni veten nëse, pak a shumë në mënyrë të pavetëdijshme, nuk jeni ju që i kërkon shqetësimet. Marsi në bashkëveprim me Venusin do t'ju favorizojë në ndërmarrjen e projekteve të reja. Filloni punën menjëherë.

GAFORJA

Tensionet e lidhura me probleme profesionale do të lehtësohen vetëm nga ëmbësia e personit të zemrës, që sot do të jetë më e theksuar. Nuk ndiheni të qetë brenda vetes, sepse nuk arrini të zgjidhni midis dy pretendentësh që ju kanë magjepsur.

LUANI

Kini kujdes dhe mos i hidhni shumë benzina zjarrit të lojërave të pushtetit dhe keqkuptimeve. Jini të drejtëdrejtë dhe të sinqertë, dhe do të arrini shpejt të gjitha objektivat që i keni vendë vetes. Kërkon qartësi në raportet në punë tek kontaktet e reja.

VIRGJERESHA

Më të paqta e më pak agresiv, edhe pse duhet të qortoni dikë që nuk është shumë i vëmendshëm. Vëreni veten gjithmonë në pozicionin e tjetrit, përpara se ta kritikoni. Në çastin më të posaçëm do të dini gjithmonë t'i rimerrni në dorë frerët e situatës.

PESHORJA

Nëse nuk jeni të sigurt për ndjenjat tuaja, mos hyni në lojë: rrezikoni të krijoni ndonjë situatë të pakëndshme, për të cilën mund të pendoheni. Përpara se t'i futeni kokë e këmbë një ndërmarrjeje, do të ishte mirë të vlerësonit të mirat dhe të këqijat.

AKREPI

Një e fshehtë sot, një e fshehtë nesër, rrezikoni të mos mbani më mend se cila është kështjella e fantazisë që keni ndërtuar. Më mirë të ktheheni në realitet! Nëse keni në mendje në lidhje nga e kaluara, mos u angazhoni për të ardhmen, madje as në të tashmen.

SHIGJETARI

Nëse jeni duke jetuar një histori të bukur dashurie bëni kujdes për të mos komplikuar atë që është e thjeshtë dhe e drejtëdrejtë. Kush është beqar ka mundësi të shkëlqyer për një takim të këndshëm. Organizoni një shëtitje në natyrë për të medituar mbi zgjedhjet e juaja më të fundme.

BRICJAPI

Për sa u përket ndjenjave, duhet të zgjidhni me zgjuarsi personat që frekuentoni, nëse nuk doni të humbi kohë me lidhje që nuk ju përmbushin. Do të kuptoni se realiteti, të cilin me raste përroni t'i shmanjeni, është më i mirë sesa ëndërrimi!

UJORI

Nuk duhet të ngadalësoni ritmin për të realizuar një projekt me sukses. Ndoshta do t'ju duhet një kohë e gjatë, por ç'rëndësi ka? Jeni në çift. Neptuni do t'ju ndihmojë të stabilizoheni dhe të ndërmerrni rrugën e qëndrueshmërisë.

PESHQIT

Urani në bashkëveprim me Saturnin ju mëshitet dhe ju dhuron intimit dhe aftësinë për t'ju marrë vesh me të gjithë, edhe me heshtje. Mos merrni përsipër shumë angazhime që e dini se nuk keni mundësi t'i menaxhoni. Mësoni të thoni jo.

Lapsi.al

"Spartak Stadium", Moskë ora 20:00

Suthgejt: Koha të shkruajmë historinë e Anglisë

Gerëth Suthgejt u ka bërë thirrje lojtarëve të Anglisë që të fshihet nga kujtesa e njerëzve dëshitimet e së shkuarës. "Tre luanët" nuk fitojnë një ndeshje me eliminim që prej vitit 2006 kur një goditje dënimi e shkëlqyer e David Bekhamit ndaj Ekuadorit u dha një vend në çerekfinale, ndërsa me Kolumbinë hera e fundit që janë përballur në një turne madhor ka qenë në vitin 1998, kur Anglia fitoi 2-0 me gola të Anderton dhe Bekhamit. "Kanë kaluar 12 vjet që kur kemi fituar një ndeshje me eliminim, kështu që kemi



një mundësi të madhe para që të bëjmë m e shumë sesa eksperiencat e së shkuarës.

Mendoj se lojtarët janë gati ta kapin shansin e tyre. Gjithsesi duhet të tregohemi të kujdesshëm. Kolumbia është e fortë dhe boll të shohim që jashtë kanë dalë Spanja e Gjermania. Këto skuadra që arrijnë të eliminojnë të mëdhatë duhen respektuar. Ato po tregojnë se ka shumë vende që po rrisin një gjeneratë të re lojtarësh dhe unë mendoj se Anglia është një nga këto vende".

Pekerman: Është një mundësi e mirë për Kolumbinë



Për Hoze Pekermanin, ajo ndaj Anglisë mund të jetë praktikisht etapa e fundit e një karriere që nisi dikur me taksinë e famshme dhe që e ka parë të udhëheqë në Botëror Argjentinën dhe Kolumbinë. Aventura me "Abiselesten" u mbyll në vitin 2006, në çerekfinale e humbur ndaj Gjermanisë me penallti, ndërsa ndaj Anglisë pritet një tjetër betejë e fortë. Por Pekerman është optimist. "Jemi skuadra e vetme që u kualifikua në 1/8-at pasi humbi ndeshjen e parë, por ishim po ashtu

të vetmit që kaluam nga situatat ku duhej patjetër fitorja. Në ndeshje si kjo ndaj Anglisë, këto mund të na bëjnë punë. Sa i takon Hamesit, mund t'ju them se nuk ka asnjë problem të rëndë. Ka rikuperuar mjaft. Shpresoj ta kem gati për lojë. Nëse nuk do luajë Hames, alternative do të jetë Muriel. Kemi një mundësi të mirë për Kolumbinë. Anglezët mendojnë se janë favoritet, por më mirë kështu duke qenë sesi kanë shkuar gjërat në këtë botëror".

"Seleçao" fiton pastër, 2-0, me meksikanët, ndërsa "djajtë e kuq" përmbysin një ndeshje të çmendur

Brazili likuidon Meksikën, Belgjika, nga ferri në parajsë!

Dy skuadrat do ndeshen mes tyre në çerekfinale



Jeton Selimi

Brazili nuk stonon! Pesë herë kampionët e botës vijojnë rrugën e tyre për trofeun e gjashtë duke nxjerrë nga lufta Meksikën, një Meksikë që në grupe kishte shfaqur një nivel shumë të pëlqyeshëm loje, por që ndaj Brazilit nuk arriti të bëjë dëm. Pas eliminimit të Spanjës, tre skuadrat e fundit që e kishin fituar trofeun janë jashtë botërorit. Asnjë prej lojtarëve në kompeticion nuk e ka fituar një kupë bote, madje asnjëri prej tyre nuk e ka luajtur një finale. Brazili është gati t'i japë botës kampionët e rinj. Ndaj kundër Meksikës nuk duhej gabuar, por amerikan-qendrorët nuk kishin ardhur për shtëpitë. Të besuarit e Huan Karlos Ozorioz kontrollonin lojën dhe dalin rrezikshëm në gjysmën e parë të pjesës së parë, ndërsa Brazili do ta ngrëjë lojën e tij në gjysmën tjetër, madje do t'i shkojë shumë pranë golit, por Oçoa mban portën e paprekur, duke i dërguar ekipet në pushim me rezultatin e bardhë 0-0.



Por Brazili do të ndërrojë menjëherë marsh me fillimin e pjesës së dytë, ndërsa do të prishtë ekuilibrat në minutën e 51-të. Uillian çan në të majtë dhe harkon tokazi për në shtyllën e dytë, aty ku Nejmar vjen rrufeshëm dhe shtyn topin në rrjetë. 1-0 dhe "seleçao" është në avantazh. Meksika tronditet. Mbase e kishin menduar ndryshe ndeshjen dhe nuk arrin të kthjellohen, ndërsa Brazili

këmbëngul të gjejë golin e sigurisë, por gjuajtjet e Paulinjosh dhe Uillianit do të grushtohen nga Oçoa, më i miri për të tjihtë në fushën e lojës. Brazili është dominues dhe do t'u dhurojë tifozëve të tij një fund-takimi të qetë, pasi në minutën e 88-të verdhëshilët bëjnë një aksion fotokopje me atë të golit të parë, por kësaj here ai që shërben asistin është Nejmar, ndërsa rrjetën e tund Firmono. Përfundimisht

2-0 në "Samara Arena", Brazili vijon rrugën më tej në këtë Kupë Bote, ndërsa Meksika kthehet në shtëpi. Belgjika, nga ferri në parajsë Nëse nuk e keni parë ndeshjen Belgjikë-Japoni, keni bërë një gabim të madh. Kjo sepse rrallë ndodh që në një botëror të shijosh emocione të tilla të forta. Japonia befason në startin e ndeshjes dhe krijon që në sekondat e para një mundësi të mirë me Kagavën, gjuajtja

e të cilit qeth shtyllën e Kurtuas. Aziatikët janë më të kërkues dhe u imponojnë lojën e tyre belgëve, por me kalimin e minutave "djajtë e kuq" e ngrënë shumë lojën e tyre dhe detyrojnë Japoninë të tërhiqet në mesfushën e saj. Por pavarësisht lojtarëve shumë teknikë, Belgjikës i mungon pasimi i fundit, ndërsa me gjuajtjet nga distanca, ai që është në gatishmëri është Kavashima, që grushton ato tentativa që i vijjnë në kuadrat. Japonia kërkton të gjejë ndonjë kundërsulm fitues, por nuk ia del, ndërsa, Belgjika varet e gjitha nga lëvizjet e Hazar. Në fund të pjesës së parë Kurtua mund të bënte ofensivë e botërorit, por devijimi i Oçoa nuk pati forcën e duhur. Pjesa e parë përfundoi me rrjetën të paprekura, ndërsa e dyta është një mrekulli e futbollit. 45 minuta të hatashme, me gola dhe situata të pabesueshme, përmbysje të atilla që ndodhin një herë në 1000 ndeshje. Japonia e nis si shpërthim vullkanik. Genki Haraguçi

shfrytëzon në perfekcion asistin e Shibasakit dhe me të djathtën tund rrjetën e Kurtuas. Japonia në delir, por Hazar një minutë më pas ka në këmbët e tij mundësinë për të baraspeshuar gjithçka. E djathtë e dhunshme, por vetëm shtyllë! Duket sikur Belgjika do bëjë çmos të rikthehet sa më shpejt, por ata që shënojnë janë sërish japonezët. Inui nga distanca shkarkon të djathtën dhe e bën të kotë fluturimin e Kurtuas. Topi në rrjetë dhe belgët nuk u besojnë asaj që shohin. Para syve u kalon fantazma e Gjermanisë, Spanjës dhe Portugalisë. Duket se ata do jenë viktima e radhës e skuadrës së vogël. Të tronditur ata hidhen të gjithë në sulm, paksa të organizuar, por me vrull e dëshirë. Gjithsesi, ai që i hap rrugën përmbysjes së madhe është Jan Vertongen. Me kokë mbrojtësi kthen drejt zonës, por topi shndërrohet në një parabolë të pakapshme për

Kavashimën. As 5 minuta dhe vjen barazimi. Kësaj radhe nga Felaini, sërish me kokë. 2-2 dhe ishim aty ku e nisëm, në barazim. Japonia provon me Hondën të mposhtë Kurtuan, por përgjigjet gati portieri i Belgjikës, ndërsa të besuarit e Martinezit këmbëngulin sërish me kokë, gjuajtjet të njëpasnjëshme, por pa gjetur kuadratin. Duket se gjithçka do të shkojë në shtesa, por jo. Kurtua nis me dorë aksionin perfekt, një kundërsulm i gjithi në shpejtësi me Munier që harkon tokazi në zonë. Lukaku bën një finte që mashtron mbrojtjen dhe Çadli shfaqet i lirë para Kavashimës. Gjuan fort e saktë, gold he 3-2. Belgjika e kanë përpara drejt çerekfinaleve, atje ku e pret Brazili, ndërsa Japonia do të kthehet në shtëpi, por pavarësisht humbjes, të besuarit e Akira Shinosha na dhuruan një ndeshje nga ato që do të hyjnë të bëjnë pjesë në folklorin e futbollit.

Për Suedinë data 3 korrik është me fat pasi 24 vite të shkuara në botërorin "USA 1994", eliminuan Arabinë Saudite dhe u renditën të tretët pasi mposhtën Bullgarinë në finale e vogël, prandaj dhe nordikët shpresojnë të kenë edhe fatin me vete ndaj Zvicrës. Gjatë konferencës për shtyp, trajneri Jane Anderson, përsëriti frazën e tij më të shprehur gjatë këtij botërori. "Është sërish një situatë ku duhet të japim maksimumin nëse duam të qëndrojmë në këtë Kupë Bote. E di që po e përsëris shpesh këtë të, por besoj se

"Krestovski Stadium", Shën Pjetërburg, ora 16:00

Andersen: Duhet të jemi në top formë për të mposhtur Zvicrën

është një përshkrim i mirë për situatën dhe se çfarë duhet të bëjmë individualisht dhe si ekip. Duhet të jemi në nivelin tonë më të lartë, vetëm atëherë mund të kemi shans ta mposhtim Zvicrën". Andre Grankuist e mendon ndryshe. Edhe pse Zvicra është forcë e gjashtë në botë, ajo nuk është një shkollë futbollit, por kjo nuk

do të thotë se Suedia do t'i nënvlerësojë ata. "Ne e dimë forcën tonë dhe pikat tona të dobëta, ndaj dimë si të kujdesemi për to, sikurse Zvicra ka qenë një skuadër shumë e mirë për një kohë të gjatë dhe se është favorite për këtë ndeshje. Ndaj ideja se mund të nënvlerësojmë kundërshtarin tonë, nuk ekziston".


Vladimir Petkoviç e di shumë mirë se kjo është një ndeshje e vështirë. Të luan ndaj Suedisë nuk është asnjëherë e lehtë dhe trajneri boshnjak i Zvicrës, ka gati planin kundër nordikëve. "Në tre ndeshjet e para e futëm veten tonë në vështirësi. Kundër Suedisë dëshirojmë ta marrim kontrollin e ndeshjes që nga fillimi. Do të jemi njësoj të uritur siç janë edhe tifozët tanë që kanë udhëtuar në Shën Pjetërburg. Mesa duket, kemi ndezur shpresën e fansave tanë në Zvicër". Xhakën duan ta pro-

Granit Xhaka nuk u druhet provokimeve: Janë pjesë e lojës

vokojnë. Suedezyt e dinë që Graniti është gjaknxehtë dhe më herët mbrojtësi suedez Lustig pat thënë se do të dëshiron ta shikonte shqiptarin të ndëshkuar me karton të kuq. Gjithashtu mesfushori nuk i druhet penalltive, ndonëse ndaj Polonisë në Europian e pat humbur në fazën e 1/8-ave. "Po e kam dëgjuar, më kanë thënë miqtë. Kjo

nuk është ndeshja ime e parë, nuk më bëjnë përshtypje këto gjëra. Provokimet janë pjesë e lojës. Kam mësuar shumë gjëra nga e shkuara. Penalltitë? E bëj gjumin e qetë. Ne do të kërkojmë ta mbyllim ndeshjen brenda 90 minutave. Nëse puna vjen te penalltitë, do ta marr për sipër përgjegjësinë nëse trajneri ma cakton".

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

1. Mund të jetë një arkë.
8. Fillojnë ndeshjen
9. Paul që këndon Diana.
10. Spagna që këndon ën Itali.
13. Fillojnë lojën.
14. Gjysmë tepsie
17. Mund të jenë ekspres.
18. Qe babai i mjekësisë.
21. Eshhtë si ballon.
22. Lind një në kokë.
24. Janë ministri.
25. Pak normalitet.
26. Një pjesë e edukatës.
27. Inicialet e Asimov.
28. Eshhtë e vrara në kufhtë.
30. Iglu te Lazio.
31. Inicialet e Redford.
33. Mbetet në fund.

34. Pak analogji.
35. Eshhtë vdekje e autorizuar.
39. Një numër femrash.
42. Në krye të modernistëve.
43. Kërkojnë talent.
44. Mbetet në fund.
45. U vra me një grushgtn nga Odiseu
47. Bëhet në start.
49. Catherine aktore.
50. Ishte babai i Odiseut

VERTIKAL

1. I famshëm ai i Trojës.
2. Një...FIAT.
3. Mbyllin një hark.
4. Eshhtë si sarkazmë.
5. Fillojnë ideologjinë.
6. Ushtrohet me cd fable.
7. Në këtë moment.
8. King Cole i muzikës.
11. Janë si cilësi.
12. Fillojnë nazet.
15. Flet për bëmat e kreshnikëve.

16. Janë shërbimet me... korrespondencë.
17. Janë binarët.
18. Nënkuptojnë edhe pranga.
19. Aktet pa kufij.
20. I takojnë fituesit.
21. Quinn aktor.
22. Pak inekzistente.
23. Fillojnë dobët.
24. Rrjeshtohen në kuvetë.
29. Eshhtë divorci.
32. Një pije piratësh.
33. Zanore për perime.
36. Një peskik i rëndë.
37. Entit amerikan i hapësirës.
38. Yll anglez.
40. Gripi paa ekstreme.
41. Tiran pa kufij.
46. Në hyrje të oazit.
48. Fillojnë ilustrimet.

Fjalëkryqi (2)


HORIZONTAL

1. Marple a Agatha Christie.
4. Zanore për zulu.
6. Qyteti i Protogora-s.
11. Inicialet e Lendl ish tenist.
12. Janë tek në kufij.
14. Benigni aktor.
16. Mund të jetë me mbret.
18. Gjysmë ndikim.
20. Një dru aromatik.
21. Teke trani.
23. Janë me numër të tilla ushtarake.
24. Nusja ba çifte.
25. Iglu te Lazio.
26. Një pjesë e sipërfaqes.
27. Një fjalë... para kohe
28. Janë mashtrime... me grim.
31. Duken të gjata në pritje.


32. Skuadra merengue.
33. Eshhtë trofe sportiv.
34. Ndahen nga ortakët.
36. Një biçikletë dyshe.
39. Kalohen në gjumë.
42. Kanë dhoma për t'u zënë.
44. Një treshe në skenë.
46. As unë, as ai.
47. Aq duhet t'i bëjnë sytë vigjilentët.
48. Gjysmë armate.

VERTIKAL


1. Një legjendë.
2. Përfundojnë një stil.
3. Shkruehen për filma.
5. Janë malet ruse të tilla
6. Agjenci Botuese Lokale.
7. Një kontestues i viteve shatërdhjetë.
8. Në krye të drejtuesve.
9. Eshhtë racë kombi.
10. Steiger aktor.
13. I vihen kalit.
15. Një britmë në corrida.
16. Një gjellë gratis.
17. Rolet pa zë.
19. Eshhtë e hollë dhe therëse.
20. Një bërjetës pylli.
22. Janë pamje nga puna.
26. Janë aksione për gol.
27. Janë maskarënj.
28. Tre në tetëdhjetë.
29. Emri i parë i Fassbinder.
30. Fillojnë turnin.
32. Kupa e fituar gjithmonë nga Brazili.
34. Eshhtë Organoziata e skuadrave të Formula 1.
35. Mbyllin punimet.
37. Ndodh në kufij.
38. Një pëlhurë.
40. Pak tradicionale.
41. Një cigan.
43. Fillojnë lehtë.
45. Mbyllin një manastir.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

PËRGJIGJE TË NUMRIT TË KALUAR

A	R	K	S	I	K	E	N	D	E	T				
T	R	U	P	N	M	K	G	E	N	T				
A	M	A	R	C	E	L	P	R	O	U	S	T	E	M
A	T	A	D	R	I	E	N	R	U	B				
R	E	A	L	M	O	L	P	I	P	P	O			
G	R	E	M	I	N	E	T	A	P	A	T			
D	U	E	L	L	E	T	I	H	E	R	A			
L	T	E	A	R	K	A	H	A	M	N				
E	L	H	A	N	E	S	O	R	E	A	I			
S	A	A	D	I	T	E	N	D	E	R	K			
I	E	R	A	T	A	P	A	P	A					

FJALËKRYQI (1)

M	I	Z	A	T	E	K	I	M	P	E	T	
P	A	R	I	M	E	T	A	M	I	T	A	
A	M	I	N	T	E	M	A	T	I	K	E	
K	I	S	K	O	M	U	N	I	T	A	R	E
E	A	P	A	R	A	L	E	L	I	E	P	
T	D	A	N	A	T	M	E	I				
A	K	O	M	A	S	T	A	F	E	T	A	T
I	A	M	I	L	P	I	R	A	T	T	E	
P	A	R	E	T	I	E	T	L	E	T		
G	O	T	T	I	N	A	A	D	E	T		
R	E	S	P	A	P	L	A	N	I			
A	N	T	I	P	A	T	I	K	E			

FJALËKRYQI (2)

SUDOKU

4				3				
7		5		3				2
1	2			9	6			8
			9					
					7	8	4	
6	1	7		4		9	3	
3			7					
7	6	1			4			
					8		5	

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

4	6	9	5	8	3	7	2	1
5	7	1	4	9	2	6	8	3
8	2	3	1	6	7	9	4	5
7	3	6	8	4	9	1	5	2
9	1	4	2	5	6	3	7	8
2	8	5	7	3	1	4	9	6
6	4	2	9	1	8	5	3	7
1	9	7	3	2	5	8	6	4
3	5	8	6	7	4	2	1	9

Argëtim filozofik

- Të bësh çfarëdo që të pëlqen, është liri. Të të pëlqejë çfarëdo që bën, është sukses.
 - Kurrë nuk do të arrini në destinacionin tuaj në qoftë se ndaloni dhe i gjuani me gurë çdo qeni që leh.
 - "Pranojmë dashurinë që besojmë se e meritojmë"
 - "Diçka duhet të bëj" gjithmonë zgjidh më shumë probleme sesa "diçka duhet të bëhet".



Thënie të mëncura

- - Problemi më i madh i komunikimit, është se, nuk dëgjojmë për të kuptuar, por për t'u përgjigjur.
- - Tragjedia e kohës sonë është se, e majta është kundër kombit dhe e djathta kundër shtetit.
- - Ndjeni keqardhje për të pasurit: në qoftë se i ruajnë paratë e tyre, konsiderohen dorështrënguar, në qoftë se shpërdorojnë për veten e tyre, egoistë, dhe nëse i ndajnë me të varfërit, budallenj.

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm

4	19	5	6	4	6	6	1	4	1	7		
1	15		11	8	8	6	5	L	I	M	A	
17		14	8	5	8	12	1	7	8	7	5	
6	3	7	9	6	1	13	8	7		14	8	
17	9	6	19	13	3	7	3	7	3	7	13	
9	16	8	15	1	7	9	15	8	7	7	7	
		13	3	8	8	13	9		12	1		
16		4	13	13	3	6	1	5	5	3		
1	6	3	1	13	7		17		9	4	8	
13		9	7		8	17	3	16	9	15	8	
3	7	13		8	7	3	5	8	13	3	8	
17	15	3	6	3		4	3	15	7	1	17	3

D	E	N	A	N	C	U	E	S	I	T	C			
O	D	A	T	H					T	R	U	P		
G	D	T	A	R	T	A	R	E	T		U			
K	A	M	E	R	I	E	R	E	T		U			
K	O	R	I	B	A	N	T	E	T		S	R		
C	M	Z	A	N	O	R			I	T	A			
O	L	A	G	A					O	N	B			
S	D	O		I	O	M			T	E	N	D	A	
T	I	N	K	A					I	A	R	I	A	N
U	N		R	E	D	I	P	I		L	O			
H	A	P	A	T	A	L	I		N	E	R			
I	S	P	O	T	G	A	Z	E	T	E				

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE

GSH.AL

GSH

www.gsh.al

- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

Tashmë edhe lundroni!

